



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit
Studime pasdiplomike - Menaxhimi dhe udhëheqja në arsim

Bashkëpunimi prind - mësues - nxënës
në shkollat fillore në Bujanoc

Kandidatja:

Emine Emini

Mentor:

Prof.dr. Arafat Shabani

Shtator 2019, Tetovë

Strukturimi i punimit

Abstrakti

Përmbajtja

Hyrja.....1

Kapitulli I

Faktorët mësimorë bashkëpunues nxënësi-prindi -mësuesi.....3

1.1. Nxënësi.....3

1.2. Prindërit.....4

1.3. Mësuesi.....5

1.3.1. Tipat e mësuesve.....6

1.3.2. Karakteristikat e mësuesve të suksesshëm.....7

Kapitulli II

2. Bashkëpunimi.....8

2.1. Bashkëpunimi mësues- nxënës.....9

2.1.2. Bashkëpunimi i mësuesit tradicional.....14

2.1.3. Bashkëpunimi i mësuesit të shek 21.....15

2.1.4. Bashkëpunimi mësues-nxënës përmes komunikimit.....17

2.1.5. Të mësuarit bashkëpunues.....19

2.2. Bashkëpunimi prind-mësues.....21

2.2.1. Ndërveprimi prind mësues mund të realizohet duke marrë këshillat për mësuesit.....23

2.2.2. Mbledhjet prindër mësues26

2.2.3. Informimi I prindërve	29
2.2.4.Komunikimi prind-mësues.....	31
2.2.5.Bashkëpunimi prind mësues përmes detyrave të shtëpisë.....	33
Kapitulli III	
Qëllimi i hulumtimit.....	36
Hipoteza.....	36
Metodologjia e hulumtimit.....	37
Kapitulli IV	
4.Analiza e të dhënave.....	38
4.1.Pyetëtori për prindër.....	38
4.2.Pyetëtori për nxënës.....	51
4.3.Pyetëtori mësuesve.....	62
4.4. Diskutime mbi rezultatet.....	73
Përfundimi.....	76
Literatura.....	77
Shtojca ANEKS.....	79
Pyetësor për mësues.....	79
Pyetësor për nxënës.....	83
Pyetësor për prindër.....	87

Abstrakti

Sistemi arsimor tani më ka ndryshuar, që ky sistem të mos jetë në krizë arsimimi i nxënësve duhet të jetë punë ekipore.

Mësuesi në rolin e tij duhet të punojë vazhdimisht shumë fort, ta kryej rolin e tij me sukses në shkollë dhe jashtë saj. Por është e vështirë që me nxënësit të punohet vetëm nga ana e mësuesit. Duke u bërë prindërit të përgjegjshëm për rolin e tyre me fëmijët mund të realizohet me sukses procesi mësimor nga ana e mësuesit si dhe të arrihet suksese tek nxënësit, pasi që për një fëmijë prindërit janë forca dominuese në shtëpi dhe mësuesit forca dominuese në shkollë.

Sa më shumë që përfshihen prindërit s'bashku me mësuesin në procesin mësimor aq më shumë do të ketë sukses nxënësi.

Prandaj një trekëndësh mësues-nxënës-prind, është i nevojshëm në jetën e fëmijës dhe një prind dhe mësues duhet ta pranojë këtë bashkëpunim në trekëndësh. Bashkëpunimi mes mësuesit, nxënësit dhe prindit, fillon që nga ardhja e nxënësit në shkollë. Është e dobishme dhe domosdoshme, që në shkollë të ekzistojë një lidhje e ngushtë mes mësuesit dhe prindit për të mirën e fëmijës.

Synimi i këtij hulumtimi është që të hulumtohet sa më shumë rreth bashkëpunimit në këtë trekëndësh, si qëndrojnë raportet në shkollë mes mësuesit, nxënësit, prindit dhe sa është i nevojshëm ky bashkëpunim. Sa bashkëpunon mësuesi me nxënësit, si bashkëpunon dhe sa janë prindërit të gatshëm në këtë bashkëpunim për ta përgatitur fëmijën për jetë. A përdoret aq sa duhet ky trekëndësh në shkollë?

Hulumtimi do të bëhet nga klasa tretë (III) deri në të tetën (VIII) përmes pyetësorëve në shkollat fillore siç janë: “Desanka Maksimoviç“ - Bilaç, Muharrem Kadriu-Tërrnoc, “Naim Frashëri”- Bujanoc.

Në hulumtim do të jenë tre pyetësorë, për prindër, mësues, nxënës, ku do të marrin pjesë 90 prindër, 90 nxënës, 45 mësues. Hulumtimi do të bëhet me metodën sasimore të dhënave mbledhjen dhe përpunohen.

Fjalët kyçe: Edukimi i nxënësve, partneriteti nxënës-mësues-prind, bashkëpunimi, komunikimi

Abstract

The education system now is changing, so this system not to be conjuncture the education of students should be developed in team works.

The teacher in his role he should work constantly very hard, to act his role successfully at school and outside. But it is hard to work withy students only by teachers support. While children being responsible for their role to work with children, the process of education could be realized successfully by teacher side in order the success to be reached at the students,so while for one child parents are the dominate force at school.

As much are involved the parent together with the teacher in process of education, that much would succeed a student.

Therefore a triangle teacher-student-parent it is necessary inchild's life, and one parent and a teacher-student and one parent and a teacher should accept this collaboration among teacher-student and a parent starts since the student arrives at school.

It is useful and necessary to exist a link at school among teacher and a parent which is helpful for a student. The goal of this survey is to be investigated that much about this triangle: teacher-student-parent and how is neccessary this collaboration. How much the teacher collaborates with students, how are ready parent for this collaboration to prepare their child for life.

Is it used this triangle at school as it is neccessary?

The survey will be done by some questonnaires from the third grade (III) up to eighth grade (VIII) at the primary schools: "Desanka Maksimovic " in Bilaca, "Muharrem Kadriu " in Ternoc , and "Naim Frasheri " in Bujanoc.

The survey has three questionnaires: for parents, teachers and students, where will get part 90 parents, 90 students and 45 teachers .The survey will be done by evaluation methodology ans the data will be collected and proceses.

Keywords: parent-teacher-student , partnerships, early childhood education, cooperation, communication

Hyrja

Arsyeja dhe kuptimi i ekzistimit të shkollës është mësimi. Leksionet janë pjesë e veçantë e interaksionit të nxënësve me mësuesit e tyre, ndërsa shkolla është vend specifik ku manifestohen të gjithë interaksionet e ndërsjella. Kjo njëkohësisht është edhe diçka më tepër, pra vend ku zhvillohen një varg ngjarjesh të ndryshme kulturore, sportive edhe nga konteksti i kompleksitetit shoqëror dhe marrëdhënieve ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve në procesin edukativo-arsimor. Pos pjesëmarrësve nxënës- mësues, pjesëmarrës në shkollë janë edhe prindërit të cilët i japin shkollës apo nxënësit përkrahje për sukses. Prindërit janë më së tepërmi të interesuar që shkolla të jetë mjedis më i sigurt për nxënësit.

Gjithmonë te njerëzit është prezent bindja se mësuesit duhet të ligjërojnë, ndërsa nxënësit t'i dëgjojnë ato dhe të mësojnë. Koha në të cilën jetojmë i hedh poshtë tërësisht këto konstatime dhe në praktikë e bën demantimin e tyre. Nxënësit gjithnjë e më tepër kanë peshë të rëndësishme madje edhe dominante në ekzistimin e shkollës¹.

Arsimi dhe shkolla janë faktorë të rëndësishëm të strategjisë së ndërtimit dhe të zhvillimit të një vendi. Nuk mund të bëhet fjalë për faktorë dominant pa u ndalur së pari në zhvillimin ekonomik të një vendi, krahine apo rajoni, pa u ndalur së pari në arsimin dhe shkollën e tyre.

Shkolla është institucion i organizuar dhe i specializuar për edukimin e nxënësve. Ajo lindi në një periudhë të caktuar për arsimimin dhe edukimin e brezit të ri dhe kryen disa funksione:

- Akademik: aftësim intelektual.
- Profesional: përgatitje për punën.
- Shoqërore e qytetare: aftësim për sjellje në shoqërinë demokratike.
- Vetjake: zhvillim cilësish të personalitetit.

Shkolla nuk mund të funksionojë mirë në qoftë se personeli që punon në të nuk ka arsim të mjaftueshëm për t'iu përshtatur kërkesave të planeve dhe prog.rameve mësimore, si dhe kur nuk

¹ Jashari, H. (2005). Sociologjia e arsimit. Fq.15,78, 97,98

i nënshtrohet një kualifikimi të vazhdueshëm. Grupet kryesore: mësuesit dhe nxënësit krijojnë marrëdhënie të brendshme bashkëpunimi, ndihmë të ndërsjellë në gjirin e tyre në shkollë².

Roli i mësuesit është bërë shumë i vështirë dhe tejet i ndërlikuar. Mësuesi tani është në një teren të ri social ekonomik, në kushte sociale dhe kulturore që ndryshojnë me shpejtësi marramendëse. Tani ka ndryshuar koha, shkolla dhe nxënësi. Kjo do të thotë se këto ndryshme duhet të reflektohen në punën, profesionin dhe personalitetin e mësuesit. Mësuesi nuk është vetëm profesion pedagogjik, por ka një mision të vështirë social, ku kjo do të thotë se e ka jetën e vet të lidhur me profesion dhe me synimin për t'i dalë me sukses punës së tij.³

Në botën e përparuar roli i prindërve në mbarëvajtjen e punëve në shkollë është i konsiderueshëm. Ata janë të pranishëm në jetën e shkollës. Me gjykimet, qëndrimet dhe me kontributet e tyre ata bëjnë që shkolla të neutralizojë çdo problem, të ketë arritje, të realizojë objektivat e saj.

Gaston Mialaret, citio: "Nevoja pjesëmarrjes së prindërve në shkollë është fakt jetik për shoqërinë".(në Muka.V)

Me nxitjen e prindërve dhe me mbështetjen e tyre nxënësit mund të bëhen veprimtarë shembullor.⁴

² Kraja, Musa. (2006). Pedagogjia. fq. 118.

³ Tushi, Gëzim. (2017). Edukimi në familje dhe në shkollë. fq. 253.

⁴ Muka, Vladimir. (2000). Për drejtimin e shkollës. Fq. 69-70.

KAPITULLI I

1. Faktorët mësimorë bashkëpunues nxënësi-prindi-mësuesi

1.1. Nxënësi

Nxënësi është një qenie e ndërlikuar nga një sërë faktorësh që formojnë personalitetin e tij. Ky personalitet duhet njohur nga mësuesi, duhet afirmuar përpara nxënësve, në mënyrë që të nxiten anët më pozitive. Njohja dhe respekti i mësuesit ndaj nxënësit, është mjet i jashtëzakonshëm për marrëdhënie të drejta dhe të qëndrueshme mes tyre.⁵

Nxënësi si faktor subjektiv në punën mësimore, paraqet strukturën më të rëndësishme sociale të sistemit multifaktoral, për të cilën organizohet e tërë puna mësimore. Prandaj, nxënësi si individ në strukturën e vetë individuale dhe nxënësit si kolektiv në strukturën e sociale, përbëjnë unitetin kompleks të faktorit mësimor, të cilët për herë dhe në mënyrë direkte ndikojnë në procesin mësimor. Nxënësi me rolin dhe pozitën e tij në mësim ndodhet në marrëdhënie reciproke me të gjithë faktorët e sistemit multifaktoral, gjë që këto raporte të nxënësit ndaj faktorëve të tjerë mësimorë dhe anasjelltas, kanë qenë gjithnjë dhe janë të kushtëzuar nga rrethanat e ndryshme historike –shoqërore.⁶

Tiparet e nxënësit që nisin dhe zhvillohen në fëmijëri, janë të rëndësishme dhe kondicionojnë kualitetin e bashkëpunimit me subjektet e tjera të shkollës apo edhe jashtë saj. Këto tipare janë të lidhura mes vete:

Tiparet socio-morale të nxënësit, respekti ndaj vetes dhe mjedisit, besimi në mundësitë dhe aftësitë personale të tjerëve, gatishmëria për të ofruar ndihmë tek të tjerët.

Tiparet emocionale të nxënësit, dashuria ndaj njeriut, empatia besnikëria ndaj fjalës së dhënë.

Tiparet dominante të temperamentit të nxënësit, tipare të favorshme për bashkëpunim.

⁵ Kraja, Musa.(2006). Pedagogjia.fq,271.

⁶ Zylfiu, Nijazi. (2001). Didaktika. fq 123.

Aftësitë dhe shkathtësitë komunikative të nxënësit, i hapur dhe aktiv, dëgjim i vëmendshëm, të kuptuarit adekuat të informacionit etj. tipare që ndihmojnë për një bashkëpunim në shkollë me nxënësin.⁷

1.2. Prindërit

Për rolin dhe rëndësinë e prindërve në realizimin e suksesshëm të punës mësimore në teorinë e mëimit „është folur në veçanti.”Shkolla amnore” e J.A. Komenskit (në Nijaziu.Z) është një nga veprat që rrjedh nga vetë kërkesa që shtron karakteri i organizimit të punës, në këtë drejtim të arsimit pedagogjik të prindërve. Prindërit si faktorë me rëndësi në procesin e edukimit dhe të arsimit të fëmijëve, kanë rol të shumëfishtë. Në një anë ai në mënyrë direkte përcjell dhe kontrollon punën dhe zhvillimin e fëmijës duke u kujdesur që t’i krijojë kushte sa më të mira për punë dhe në anën tjetër, roli i tij manifestohet me punën e suksesshme të nxënësit në klasë. Prandaj bashkëpunimi me prindër në forcimin e rolit edukativo-arsimor të shkollës ,si dhe në ngritjen e efikasitetit të plotë të punës mësimore, luan rol me rëndësi në këtë drejtim.⁸

Për një bashkëpunim mes prindit dhe mësuesit apo shkollës, varet edhe nga tipat e prindërve, ku tipat e prindërve mund të jenë bashkëpunues dhe jo bashkëpunues.

Prindi bashkëpunues ka tiparet:

- komunikativ, shpreh mendimet dhe porositë e tij në situatë të caktuar, ku këtë e bënë me fëmijën nxënës, me mësuesin apo personelin e shkollës.
- I hapur, nuk i refuzon por i pranon mesazhet nga të tjerët, nga partneri, apo fëmija nxënës, nga shkolla.
- vlerësues, reagon me arsye rreth informacionit jo vetëm të dërguar por edhe të pranuar nga dërguesi.

⁷ Zuna Deva, Afërdita. (2009). Partneriteti shkollë-familje-komunitet. Fq. 135-136

⁸ Zylfiu, Nijazi. (2001). Didaktika. Fq. 135

- meditues, mendon për informacionet e pranuara nga dërguesi.
- aktiv, ndërmer hapa konkret për të zgjidhur situatën e caktuar brenda familjes, shkollës.
- I gatshëm për ndryshime dhe riparime, me qëllim që të përmirësohet bashkëpunimi.

Tiparet e prindit jo bashkëpunues apo bashkëpunim i vështirë:

- I mbyllur, pa mundësi që të dërgojë apo të pranojë mesazhe të dërguara apo të pranojë mesazhe të caktuara.
- subjektiv, i vërshuar nga emocionet që pamundëson pranimin dhe vlerësimin, por edhe ndërmarrjen në situatën e partneritetit apo bashkëpunimit.
- I vetëpëlqyeshëm, që është i bindur se vetëm mendimet dhe veprimet e tij janë të drejta, ai është i pagabueshëm .
- Kritiker, reagon në mendimet dhe veprimet e të tjerëve duke i kritikuar, por duke mos i arsyetuar apo argumentuar.
- refuzues, duke menduar se partnerët tjerë nuk janë të denjë për bashkëpunim me të.
- fajësues, gjithnjë në kërkim të fajtorit, kurrë në kërkim të mundësisë.
- pesimist, nuk sheh kurrfarë mundësish apo zgjidhje për bashkëpunim- partneritet.⁹

1.3. Mësuesi

Platoni duke cekur rolin e mësuesit në përgatitjen e brezit të ri për jetë, mësuesin e veçon në shoqëri për nga roli dhe rëndësia që ka. Naim Frashëri në bazë të rezultateve të arritura në fushën e teorisë dhe praktikës mësimore, lidhur me rolin e faktorit të edukatorit, thotë mësoni na kanë thënë të urtë, fëmijën tuaj të dinë më shumë se ju, se ata janë, për një kohë më tej nga koha juaj.¹⁰

Mësuesi është forca kryesore organizative për veprimtari mësimore edukative në institucionin shtetëror. Shkolla nuk mund të funksionojë mirë në qoftë se personeli që punon në të nuk arsim të mjaftueshëm për t'iu përshtatur kërkesave të planeve dhe programeve mësimore, si dhe kur nuk i nënshtrohet një kualifikimi të vazhdueshëm.

⁹ Zuna Deva, Afërdita. (2009). Partneriteti shkollë-familje-komunitet. fq 142-143

¹⁰ Zylfiu, Nijazi. (2001). Didaktika. fq 125-126

Personaliteti i mësuesit është pjesë e profesionalizmit të tij. Kur flasim për personalitetin e mësuesit kemi cilësitë morale dhe profesionale të tij. Disa nga këto cilësi shprehen në bashkëpunimin me nxënësit, filozofinë mësimdhënëse dhe sjelljen njerëzore.

Mësuesi është hallka kryesore e veprimtarisë në shkollë. Ai është drejtues organizues i procesit mësimor, interpretues i dokumentacionit shkollor, nga puna e të cilit varet veprimtaria e tërë hallkave që veprojnë në shkollë, ose në lidhje dhe bashkëpunim me të. Me mësuesin janë të njohur dhe të interesuar të gjithë. Së pari, si nxënës, kur kanë kaluar vitet e shkollimit. Së dyti, si prindër, kur e kanë patur dhe kanë bashkëpunëtor të ngushtë për atë që prindërit kanë më të shenjtë fëmijën. Së treti, populli, atdheu, kombi kanë tek ai të ardhmen e afërt, të nesërmen, nënat, baballarët, punëtorët dhe qeveritarët e ardhshëm. Puna e mësuesit është ndër punët më intelektuale të lodhshme dhe të madhërishtme njëkohësisht dhe ky mësues është brez pas brezi, duke përgatitur punonjësit e së nesërme, gëzon respektin dhe simpatinë e të gjithëve.¹¹

Mësuesi duhet të ketë figurë shoqërore dhe morale të rregullt. Ai krejt natyrshëm është objekt vëzhgimi nga nxënësit dhe nga prindërit. Studimet dhe vëzhgimet e shumta tashmë kanë konfirmuar se mësuesit e suksesshëm e mbajnë klasën mjaftë të organizuar, luajnë një rol të rëndësishëm në klasë, por edhe i përfshijnë nxënësit në planifikim dhe organizim.¹²

1.3.1. Tipat e mësuesve

Shkrimtari Sterjo Spasse, (në Kraja .M) personalitet letrar dhe pedagogjik i ndante mësuesit në katër grupe: në atë social; në tipin pestalocian, ekonomik etj. Por personalitetet botërore kanë bërë përcaktime të tjera tipash: Levin, Lipet i ndanë mësuesit në tre tipa: autoritar, demokrat dhe indiferent. D. Ryansa jep klasifikimin në dy tipa: demokrat dhe autoritarë.

Janë bërë edhe përcaktime të tjera tipash, por më të afirmuar janë:

Tipi autoritar: Siç e thotë vetë emri, kërkon dhe lufton për autoritet. Flet vetë, drejton veprimtarinë e nxënësve, pa përkrahur veprimet të pavarura, nuk është tolerant në shkallën e

¹¹ Kraja, Musa. (2006). Pedagogjia. Fq. 257.

¹² Musai, Bardhyl. (1999). Psikologji edukimi. Fq. 30.

duhur, është strikt, i prerë në mënyrë kategorike. Ndikon negativisht në optimizmin e nxënësve, në nismën dhe vetëveprimin e tyre.

Tipi demokrat: është organizator i mirë, nxit nxënësit për punë, i përkrah u kërkon atyre, duke i respektuar njëkohësisht. Krijon mjedis të ngrohtë në klasë, ka humor, nxit bashkëpunimin, ndien vetë përgjegjësinë për gjendjen në klasë.

Tipi indiferent: nuk ndien, as nuk shfaq kënaqësi për arritjet, për përgjigjet e goditura, sikurse as nuk shfaq shqetësim për çrregullimin dhe mungesat që ndodhin në klasë. Ky qëndrim as i nxitë, as i mobilizon nxënësit. Indiferentizmi i tij ushqen indiferentizmin tek nxënësit. Indiferentizmi i mësuesit është varfëri e theksuar profesionale.

Ndërsa Mialaret shkruan se dallohen pesë tipa mësuesish: mësues të rreptë, të vendosur, të moderuar, elastik, ose moskokëçarës. Preferohet mësuesi i vendosur.¹³

1.3.2. Karakteristikat e mësuesve të suksesshëm

Studiuesit mendojnë se kyçi i suksesit në mësimdhënie gjendet në karakteristikat e mësuesve. Tri karakteristikat e mësuesve janë: dijet, qartësia dhe ngrohtësia.

Dijet-Mësuesit që kanë njohuri më shumë për lëndën e tyre kanë një ndikim të mirë tek nxënësit e tyre. Mësuesit që kanë më shumë njohuri rreth lëndës së tyre nuk i kanë edhe nxënësit të tillë, që të mësojnë më shumë. Dija është ndoshta e nevojshme e nevojshme, por jo e mjaftueshme për mësimdhënie më produktive.

Organizimi dhe qartësia e mësuesit ndikon në të nxënësit e nxënësve. Ekzistojnë lidhje të rëndësishme midis qartësisë, njohurisë së lëndës dhe të nxënësit e nxënësve. Mangësitë në njohuri sjellin paqartësi tek mësuesi.

Entuziazëm-ngrohtësia, të qenit miqësor dhe të kuptuarit e mësuesit, janë tiparet më të forta të lidhura me qëndrimet e nxënësve ndaj lëndës. Me fjalë të tjera, mësuesit që janë miqësorë, kanë tendencë t'i kenë nxënësit dhe klasën si vetën e tyre.¹⁴

¹³ Kraja, Musa. (2006). Pedagogjia. Fq 260.

KAPITULLI II

2. Bashkëpunimi

Bashkëpunimi- ky nocion është sinonim i nocionit partneritet apo nocionit kooperim e krahasim. Domethënia e këtij nocioni është “punë e përbashkët me dikë tjetër për të kryer një punë”¹⁵

Bashkëpunimi është një përpjekje e përbashkët e individëve ose grupeve të punës për të kryer një detyrë ose projekt. Bashkëpunimi zakonisht përfshinë aftësinë e dy ose më shumë njerëzve për të parë dhe për të kontribuar në dokumente ose përmbajtje të tjera në shkollë. Bashkëpunimi mund të jetë “jo në kohë”, në këtë rast ata që bashkëpunojnë nuk janë domosdoshmërisht të komunikojnë dhe të punojnë së bashku në të njëjtën kohë. Bashkëpunimi sinkron, i njohur si bashkëpunim “në kohë reale”, përfshin partnerë bashkëpunues që punojnë së bashku në të njëjtën kohë dhe në komunikim gjatë punës së tyre.¹⁶

Bashkëpunimi është filozofi rreth mënyrës së krijimit të marrëdhënieve me të tjerët si të mësojë dhe të punojë njeriu. Bashkëpunimi është mënyrë sjellje ndaj njerëzve, ai respekton dallimet, ndan autoritetin dhe ndërtohet mbi njohuritë që janë të shpërndara midis njerëzve të tjerë.¹⁷ Sipas studimeve të bëra bashkëpunimi përcaktohet si një proces i dy ose më shumë partive, duke punuar së bashku për të arritur një objektiv dhe qëllim të përbashkët. Bashkëpunimi është i rëndësishëm për një reflektim të praktikave dhe shkëmbimin e njohurive. Ai është përdorur si një strategji kryesore, për të krijuar kreativitet dhe inovacion për krijimin e programeve efektive arsimore.¹⁸

¹⁴ Musai, Bardhyl (1999). Psikologji edukimi. Fq. 275-276.

¹⁵ Duna Zeva, Afërdita. (2009). Pedagogjia. fq 17.

¹⁶ Techtargat. <https://whatis.techtargat.com/definition/collaboration>

¹⁷ Musai, Bardhyl. (2003). Metodologji e mësimdhënies. fq 281.

¹⁸ Adams, Donnie&Harris Alma& Jonnes Suzette, Michelle (2016).Teacher-parent collaboration for an inclusive classroom:success for every child. fq 59. Malaysian Online Journal of Educational Sciences 2016 (Volume4 - Issue 3)
<https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1106456.pdf>

2.1. Bashkëpunimi mësues- nxënës

Shikuar historikisht marrëdhëniet në relacion mësues nxënës janë themeluar sipas një modeli të vjetër ku mësuesit është dashur që të ligjërojnë ndërsa nxënësit të mësojnë. Ky model tani më nuk vlen. Në kushte të shoqërisë qytetare, demokratizimit të madh, lirive dhe të drejtave më të mëdha të njeriut, konkurrencës të gjithanshme dhe ekonomisë së tregut, model i ri do të ishte se "mësuesit dhe nxënësit janë njëkohësisht liderë të mësimin" ¹⁹ Në përgjithësi bashkëpunimi mësues-nxënës këshillohet të orientohet nga idetë e mëposhtme:

- Nxënësit duhet të marrin pjesë aktivisht në të paktën gjysmën e periudhës mësimore.
- Mundësisht çdo nxënësi duhet ti jepet mundësia të aktivizohet në një mënyrë ose tjetër.
- Pjesa më e madhe e kohës mësimore u duhet dhënë atyre aktivitete që kërkojnë mendim dhe krijimtari dhe jo riprodhimin të thjeshtë të informimit. ²⁰

Nxënësi dhe mësuesi janë dy figurat kryesore që kanë në dorë mbarëvajtjen dhe efikasitetin e këtij institucioni të rëndësishëm, unikal. Natyrisht kur flitet për marrëdhënie mësues-nxënës, afërmendsh kuptohet që bëhet fjalë për marrëdhëniet midis dy qenieve të ndryshme që kanë rol, mision dhe funksion të ndryshëm (por jo kontradiktor). Problemi i "statusit", i marrëdhënieve dhe i konfliktualitetit tradicional të përjetshëm e të natyrshëm në marrëdhëniet mësues-nxënës, sot nuk mund të shihet dhe të vlerësohet me mentalitete të "purizmit pedagogjik", as nga platforma e vjetër e pedagogjisë autoritariste, sipas maksimës pasive "kur flet mësuesi nxënësi dëgjon dhe hesht". Koha e re e lirisë dhe e demokracisë e ka detyruar shkollën moderne, për t'i përmbysur këto role të determinuara, këto pozicione të "stratifikuar" të qëndrimit dhe vlerësimit interdogmatik, të marrëdhënieve midis mësuesit dhe nxënësit. ²¹

Që një mësues të ketë marrëdhënie të mirë, duhet të ketë besim mes mësuesit dhe nxënësit, pasi që besimi është themeli i çdo marrëdhënijeje dhe është një nga gjërat më të rëndësishme për një mësues që të zhvillohet me nxënësit e tyre. Dhe ky besim mund të ekzistojë në një mjedis të

¹⁹ Jashari, Hasani. (2005). Sociologjia e arsimit. fq 103.

²⁰ Garo, Sofokli. (2013). Teoria dhe praktika e mësimdhënies. fq 150.

²¹ Tushi, Gëzim. (2017). Edukimi në familje dhe në shkollë. fq 271-272.

mirë në klasë ku mundë të krijohet përmes këtyre këshillave të Janelle Cox një shkrimtare për arsim ku thotë:

Flisni për besimin -Krijimi i besimit duhet të fillojë kur nxënësit hyjnë në klasë, filloni një bisedë me klasën tuaj se si besimi është i rëndësishëm në të gjitha marrëdhëniet, si dhe në të mësuarit.

Jepni përgjegjësitë nxënësve -Jepni përgjegjësitë nxënësve tuaj dhe besoni që ata do t'i përfundojnë detyrat që ju i keni caktuar. Nëse e sheh se një nxënës nuk e ka përfunduar punën e tyre, mos të hidhni poshtë.

Jini tolerantë -Jini të vëmendshëm ndaj përvojave negative që mund të kenë ndikuar në aftësinë e një nxënësi për t'ju besuar. Ju mund të hasni nxënës që nuk kanë përjetuar besim në jetën e tyre. Nëse një nxënës ka mësuar të mos i besojë asnjë të rrituri në shtëpi, ata nuk do të kenë asnjë arsye për t'i besuar një mësuesi në fillim.²²

Marrëdhënjet mësues nxënës mundë të ndërtohen duke bashkëvepruar mësuesi me nxënësit duke i kuptuar ,shoqëruar komunikuar ku mundë të ndërtojnë marrëdhënje të suksesshme. Sipas një studimi marrëdhënja mësues-nxënës madje e suksesshme mund të bëhet duke iu përmbajtur disa nga sugjerimet e dhëna:

1. Mësuesit dhe nxënësit duhet të kenë sukses së bashku. Për këtë, është e domosdoshme të ndërtohet ndërveprimi mësues-nxënës në klasë, në parimet si ndershmëria, integriteti, ndershmëria dhe respekti që udhëzojnë në gjithçka që bëjnë.
2. Ndërveprimi duhet të jetë një trafik i dyanshëm, por mësuesit duhet të udhëheqin dhe duhet të ndjehen të sigurt se do të jenë në gjendje të arrijnë të krijojnë dhe mbajnë një raport të shëndoshë që prodhojnë me nxënësit.
3. Mësuesit duhet t'i kuptojnë nxënësit dhe të gjejnë se çfarë kanë nevojë.
4. Nxënësve duhet të ofrohet aktivitete interesante. Aktivitetet duhet të krijohen në mënyrë të tillë që t'u mundësojnë nxënësve të angazhohen me të mësuarit, të kënaqen dhe të zhvillojnë një ndjenjë të përkatësisë në një grup koheziv.

²² Cox, Janell. How to build trust with student. <https://www.wgu.edu/heyteach/article/how-build-trust-students1808.html>

5. Mësuesi duhet të gëzojë të qenit në shoqërinë e nxënësve të tyre. Ata shpenzojnë shumë kohë me ta çdo javë dhe nëse bëjnë përpjekje për të parë kohën e kaluar me nxënësit një përvojë e këndshme, marrëdhënia me klasën e tyre ka një shans më të mirë për të qenë i suksesshëm.

6. Mësuesi duhet të jetë i sigurt që të dyja palët të fitojnë dhe të marrin atë që duan, por jo në kurriz të tjerëve.

7. Duhet të ketë komunikim verbal, si dhe komunikim jo-verbal. Është e lehtë të supozohet se ajo që është shumë e qartë për një mësues si mësues është gjithashtu e qartë për nxënësit.²³

Në shumicën e rasteve në shkolla ora e mësimit dominohet nga fjala e mësuesit dhe kjo nuk është gjë e mirë. Përfundimet e studimit të kryera nga Mc Keachie dhe Sfinicki (2006) (në Garo.S) , tregojnë se nxënësit mbajnë mend vetëm 10% atë që lexojnë, 20% të asaj që dëgjojnë, 30% të asaj që shohin, 50% të asaj që dëgjojnë dhe shohin, 70% të asaj që thonë dhe 90% të asaj që e kane bërë.²⁴ Rritja e efektshmërisë së orës së mësimit është e lidhur edhe me pjesëmarrjen e nxënësve në mësim, me dëshirat, interesat, dhe në disa raste edhe me prirjet e nxënësve dhe orientimet ,nxitjet e mësuesit në këto fusha. Ka mësues që aq ngushtë dëshirojnë të bashkëpunojnë me nxënësit sa më shumë duan të flasin nxënësit se sa ata vetë.

Pedagogu i madh Pestaloci shkruan: "Një mësim në shkollë, i cili përfshin të tërë shpirtin, të cilin edukimi i njeriut duhet të përfshijë, dhe që nuk ndërtohet plotësisht në rrethanat e jetës shtëpiake". Më tej ai shkruan "çdo ndihmë, çdo përkrahje në nevojë, çdo mësim që ata u morën, u vinte drejtpërdrejtë nga unë. Dora ime ishte në dorën e tyre, syri im shihte në syrin e tyre, ata ishin tek unë e unë isha tek ata"²⁵

Pesë mënyra për të ndërtuar një marrëdhënie të suksesshme student-mësues.

Për një bashkëpunim të duhur mësues–nxënës, së pari mësuesi duhet të jetë pozitiv dhe pastaj edhe nxënësit do të jenë në përgjithësi pozitiv.

²³ Mercinah, R & Nirmala, D. The important of student-teacher relationship in schools.

https://www.academia.edu/8058067/THE_IMPORTANCE_OF_STUDENT_TEACHER_RELATIONSHIP_IN_SCHOOLS

²⁴ Garo, Sofokli.(2018). Teoria dhe praktika e mësimdhënies. Fq. 149

²⁵ Kraja, Musa. (2006). Pedagogjia. Fq.263

Sipas Dr. Biljana Çiriç edhe pse mësuesi nuk mundë të jetë një mësues superman, mund të ndërtojë marrëdhënie të mira me nxënësit përmes pesë mënyrave:

1. Respektimi i nevojave të nxënësve -Rregulli i parë i çdo paraqitjeje publike është të njohësh auditorin tënd. Cilat janë nevojat, pritjet, frika, përvojat e saj? Nëse nuk keni një ide krejtësisht të qartë se cilët janë nxënësit tuaj, çfarë është karakteri i secilit prej tyre, ju nuk do të jeni një lektor i suksesshëm. Prandaj, autoriteti juaj varet në masë të madhe nga qëndrimi që keni dhe vlerësimi i nxënësve.

2. Demokracia në klasë -Nxënësit do të ndjekin më shumë rregulla nëse ato do të themelohen së bashku me një mësues. Fuqia juaj nuk vjen nga roli që keni, por kryesisht nga karakteri juaj. Nëse kënaqesh me vetëbesimin, ndjeshmërinë, tolerancën, entuziazmin dhe disiplinën e shfaqjes në punë, me shembullin tënd të udhëzosh nxënësit për një qëllim të përbashkët pa përdorimin e masave specifike disiplinore.

3. Të ketë synime konkrete dhe të qarta- Përmirësimi i zhvillimit të nxënësve bazohet në udhëzime dhe qëllime të qarta. Nëse një nxënës nuk e di saktësisht se çfarë pritjet prej tij, ai nuk do të jetë në gjendje t'i përmbushë idetë tuaja. Rrjedhimisht, do të jetë e pakënaqur dhe jo e motivuar për të punuar. Tregoni nxënësit se suksesi dhe progresi i tij është qëllimi juaj i përbashkët dhe të jeni gjithmonë të disponuar kur i nevojitet ndihmë për punë.

4. Lejo nxënësin të gjejë zgjidhjen e tij-Zhvillimi i teknologjive moderne ka ndikuar shumë në marrëdhëniet midis nxënësve dhe mësuesve. Me mundësitë e pakufizuara të eksplorimit, interneti i jep mundësinë studentit të bëhet një shkencëtar i ri që tashmë është në stolin e shkollës. Prandaj, roli i mësuesve po ndryshon. Ai nuk është më figura qendrore e procesit të mësimdhënies, por vetëm dikush që jep udhëzime për një metodë kërkimi të suksesshëm për gjetjen e zgjidhjeve.

5. Dëgjimi aktiv- Një veçori veçanërisht e rëndësishme e një mësuesi të mirë është se ai është në dispozicion të nxënësit sa herë që është e nevojshme. Ai e di dhe dëshiron të dëgjojë. Kështu, një mësues ndërton një marrëdhënie besimi me nxënësit e tij dhe besimi është fjala më e shtrenjtë njerëzore. Dhënia e besimit në procesin edukativ do të thotë pa frikë të fillosh një aventurë me

dijeninë se të gjithë do të jenë në anën fituese dhe gëzimi i dhënies së tillë të përbashkët nuk është i matshëm nga ndonjë vlerësim.²⁶

Mësuesi duhet të jetë i përkushtuar dhe i dashur me nxënësit, i vëmendshëm ndaj nevojave dhe ndjenjave të tyre, dhe duhet të zhvilloj tek ata frymën e shoqërisë në mënyrë që edhe ata të kenë po këto sjellje me njëri tjetrin.²⁷ Bashkëpunimi me nxënësit nënkupton gjithashtu përfshirjen e nxënësve si vendimmarrës dhe zgjidhës së problemeve, si hartues në të mësuarit e tyre dhe të vetëvendosur në planifikimin për të ardhmen e tyre. Bashkëpunimi me nxënësit nënkupton nxitjen e vetë-disiplinës dhe të mësuarit të nxënësve, përdorimin e sjelljes së përgjegjësme.

Sipas studimeve të gjetura lidhur me bashkëpunimin e mësuesve me nxënësit, ky bashkëpunim duhet të ekzistojë sepse:

- lehtëson qëllimet e shekullit 21 të edukimit të përkatësisë, mjeshtërisë, pavarësisë dhe bujarisë.
- ilustron shkollimin demokratik
- rrit vetëpërcaktimin e vetë nxënësve
- ka potencial për të rritur kompetencën akademike dhe sociale të studentëve dhe për të lehtësuar reformën në shkollë
- përfaqëson një burim të pashfrytëzuar në kohën e burimeve të kufizuara fiskale dhe njerëzore.²⁸

Një mësues bashkëpunues me nxënësit, sidomos në procesin mësimor duhet të dalloj nga mësuesi tradicional, mësuesi bashkëpunues është mësues i një klase të shekullit 21.

Bashkëpunimi mësues–nxënës duhet të ndryshoj tërësisht, dallimi përmes klasës tradicionale dhe të shekullit 21, shpjegon se si mund të jetë bashkëpunimi i mësuesit me nxënësit në klasë.

²⁶ Ćirić, Biljana. (2019) .5 Način građena uspešnog odnosa učenik-nastavnik. <http://www.institut.edu.rs/5-nacina-gradenja-uspesnog-odnosa-ucenik-nastavnik/>

²⁷ Brophy, Jere. (2003). Mësimdhënja. Doracak për arsimtarët. fq.8

²⁸ Richard A. Villa, Ed.D., Jacqueline S. Thousand, Ph.D., Ann I. Nevin, Ph.D. (2011). What can collaboration with students look like. <https://www.seenmagazine.us/Articles/Article-Detail/articleid/1301/what-can-collaboration-with-students-look-like>

2.1.2. Bashkëpunimi i mësuesit tradicional:

Një portret i pa autorizuar i mësuesit të stilit të vjetër do të ishte pak a shumë kështu: ai është shkollaresk, formalist, i rreptë. Hyn në klasë dhe flet vetë gjatë gjithë kohës, i lë nxënësit në hije, duke mos nxitur interesin e tyre me anë të debatit, diskutimit, konkursit, aplikimit, eksperimentit etj. Një orë e tillë është e dështuar pa nisur. Ai kërkon që nxënësi të mos gabojë asnjëherë, si të jetë një robot që vetëm duhet të riprodhojë mekanikisht “mësuesin” e tij. Prerja e mësuesit tradicionalist është autoritarizmi dhe brenda tij rri struktur dëshira që nxënësit ta kenë frikë. Këtij mësuesi rrallë i qesh fytyra, pasi mendon se kjo e afron më shumë se duhet me nxënësin. Nuk bën shaka, nuk është miqësor, fjalët e mira i ka me pikatore. Mbush fletoren e punës edukative me plane pune pa fund.²⁹ Bashkëpunimi i mësuesit tradicional ndryshon nga ai i mësuesit të shek .21. Mësuesit tradicional duken kështu:

- Mësuesit janë burim i vetëm informacionesh, pra vetëm mësuesit mund të japin informacion, nxënësit nuk orientohen të hulumtojnë.
- Konsiderohet se mësuesit janë njerëz të cilët e kanë kryer të nxënës të tyre. Derisa vetëm mësuesit mendojnë kështu nuk do të egzistojë bashkëpunimi.
- Mësuesit i prezantojnë informacionet e tyre përmes ligjëratave, fletoreve pune dhe fletëve pune. Këta mësues hyjnë në klase, zhvillojnë orë pa ndonjë mjet pune për të stimuluar nxënësit për orë .
- Teknikat për kontrollim të diturisë, të cilat i përdorin mësuesit, fokusohen mbi përgjigje me “e saktë/ e pasaktë ose pyetje të mbyllura. Nuk i japin hapësirë të mendojnë më gjatë mbi përgjigjen.
- Mësuesit janë përgjegjës për sjelljen në klasën dhe janë konsideruar për autoritet. Mësuesit tradicional zakonisht janë autoritar gjë që nuk ka bashkëpunim pasi aty konsiderohet vetëm mësuesi për orë mësimore.
- Mësuesit zakonisht u japin nxënësve informacione. Vetëm mësuesit mund të japin informacione pa i kërkuar informacionet nga nxënësit, apo edhe prindërit rreth zhvillimit të tyre.

²⁹ Dedaj, Ndue. (2015). Mësuesi tradicional dhe reformimi i shkollës. <https://www.gazeta-shqip.com/2015/04/03/mesuesi-tradicional-dhe-reformimi-i-shkolles/>.

- Nxënësit më shpesh punojnë vet. Tek mësuesit tradicional më shume nxënësit punojnë vet pa i ndihmuar mësuesit.

2.1.3. Bashkëpunimi i mësuesit të shek 21:

Shkollat në shekullin 21 e përfaqësojnë idenë për afrim të individualizuar i cili i respekton aftësitë dhe përpjekjet e secilit fëmijë për të krijuar mënyrën e vet për të nxënësit. Të kuptuarit e asaj që mësohet, është elementi themelor në procesin kompleks të të nxënësit. Mësuesit të cilët e përfaqësojnë këtë mendim janë drejtuar kah fëmija. Fëmija ndodhet në qendrën e procesit të të nxënësit, kurse mësuesit krijojnë mjedis i cili e reflekton këtë perspektivë. Mësuesit i drejtojnë nxënësit kah mesimit, kah sjelljes së drejtë, i inkuadrojnë në krijimet e rregullave të klasës dhe i mësojnë t'i përdorin materialet në mënyre korrekte. ata e organizojnë kohën ashtu që nxënësit të kenë kohë të flasin, hulumtojnë, t'i dëgjojnë të tjerët kur flasin dhe hulumtojnë. Edhe pse mësuesit bëjnë shumë planifikime, ata gjithashtu i inkurajojnë nxënësit që dhe vetë ta planifikojnë kohën e tyre

- Mësuesit janë fasilitatorë dhe udhëheqës në procesin e të nxënësit, që do të thotë se mësuesi i udhëheq nxënësit se si të ecin në procesin e të nxënësit.
- Mësuesit shikojnë vetveten si nxënës bashkë me fëmijët e tjerë, bashkëpunojnë aq ngushtë sa që e shohim veten si nxënës dhe kur kjo te ndodhë bashkëpunimi do të rritet më shumë
- Mësuesit krijojnë situata për të nxënësit duke i bazuar mbi përvoja të drejtpërdrejta, interaksion social dhe hulumtime.
- Mësuesit e nxitojnë të menduarën kritike tek nxënësit me pyetje të hapura, pra në mënyrë që të rrisin bashkëpunimin, vazhdimisht nxisin nxënësit të shprehin sa më shumë për atë që din.
- Mësuesit dhe nxënësit përcaktojnë rregulla për sjellje me të cilën theksohet përgjegjësia personale, asnjëherë një mësues i shek 21 nuk vendos rregulla për sjellje vetëm, por në bashkëpunim me nxënësit.

- Nxënësit punojnë në çift ose grupe të vogla, aty ku egziston një bashkëpunim i shekullit 21 apo një klasë e shekullit 21, nxënësit nuk punojnë vetëm me mësuesin por bashkëpunojnë mes vete duke i udhëzuar³⁰

Format e bashkëveprimit mënyra se si bashkëveprojnë nxënësit dhe mësuesit gjatë mësimit e përbën tërë procesin e bashkëpunimit të përfunduara në lloje të ndryshme mësues-nxënës, nxënës –nxënës apo ndonjë grup i vogël. Për të arritur një bashkëpunim të duhur apo bashkëpunim efektiv në mes njëri tjetrit pra mësues-nxënës realizohet atëherë kur :

- të dy pjesëmarrësit mund të motivojnë njëri-tjetrin;
- nxënësit , mësuesit marrin zhvillim aktiv në të gjitha sferat (aftësitë komunikuese, cilësitë personale, puna ekipore etj).
- ka gjithmonë një raport pozitiv, pra mes mësuesit dhe nxënësit ka gjithmonë një raport pozitiv në mënyrë që të rritet bashkëpunimi.
- të gjithë pjesëmarrësit flasin përkatësisht, pasi që komunikimi nga të gjithë nxënësit me mësuesin ndikon pozitiv në klasë,
- vështirësitë dhe keqkuptimet eliminohen,në rast se ka vështirësi dhe keqkuptime për një bashkëpunim efektiv duhet të eliminohen,
- detyrat dhe rolet ndahen në përputhje me rrethanat, pra detyrat iu caktohen nxënësëve në baze të mundësive që kanë.³¹

Nxënësit ndjehen të motivuar dhe të stimuluar për të mësuar dhe për të bashkëpunuar në mënyrë aktive me mësuesit, kur është klasa në drejtimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës. Kështu, roli i mësuesit është jetik për efektin e mësimit. Marrëdhënia midis mësuesve dhe nxënësve ndikon në cilësinë e motivimit të nxënësve për të mësuar dhe përvojat e mësimit në klasë. Është e rëndësishme të kemi një mësues që kujdeset për nevojat dhe pikat e forta të nxënësve të tyre dhe që mban një marrëdhënie mbështetëse me nxënësit e tyre, duke u dhënë atyre të njëjtën gjë. Aftësia e studentëve për t'u lidhur me mësuesit e tyre është një atribut që mund të bëjë një ndryshim të madh në arritjen e të nxënësve. Kur studentët mendojnë se

³⁰ Walsh Burke, Kate&Kiranxhiska Suzana&Gjorgjieva, Llazarevska, Tatjana. Krijimi i mjedisit për të nxënësit për shekullin 21.fq 21,23,39.
https://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/Krijimi_i_mjedisit_p%C3%ABr_t%C3%AB_nx%C3%ABnit_p%C3%ABr_shekull_in_XXI.pdf

³¹ E. A. Zalyeava & M. I. Solodkova (2014). Techer-student collaboration: institute of economics and finance Kazan federal university approach. <https://core.ac.uk/download/pdf/82529089.pdf> fq 1041-1042.

mësuesit e tyre janë përkrahës, njerëz të besueshëm, ata tentojnë të krijojnë një lidhje me mësuesin e tyre dhe fillojnë të shohin mësuesit e tyre si dikush që është atje për t'i mbrojtur ata dhe t'u japë atyre të gjitha mundësitë për të rritur të mësuarit e tyre dhe në të njëjtën kohë të sillen mirë. Një mjedis i mirë në klasë, është i rëndësishëm sepse klima sociale-emocionale që një mësues krijon me nxënësit do të ofrojë mundësi për ta parë veten si të aftë, të denjë dhe të sigurt të bashkësisë në klasë dhe t'i bëjnë ata të ndjehen pjesë e procesit mësimor.³²

2.1.4. Bashkëpunimi mësues-nxënës përmes komunikimit

Sot komunikimi përbënë një nga shprehitë kryesore që duhet të zotërojë çdo individ, prandaj edhe në sistemet arsimore ai përbënë një nga kompetencat bazë të nxënësve.

Komunikimi në shkolla përcaktohet si procesi prej të cilit mbartet përmbajtja e mesazhit si mjet për të krijuar të kuptuarit e përbashkët. Në klasë ka dy lloj komunikimesh : njëri është komunikimi diskutues, me anë të cilit shkëmbehen mesazhe gjatë procesit të të nxënës, është shumë i rëndësishëm dhe duhet zhvilluar në klasë, por është edhe lloji më i vështirë i komunikimit për t'u dhënë mësim, sepse për ta arritur, duhet të ketë një ndërveprim shoqëror.

Komunikimi tjetër është edhe komunikimi paraqitës shpesh merr formën e një vlerësimi përmbledhës. Komunikimi përmbledhës është me dy ose më shumë njerëz që, zakonisht kryhet vetëm në një drejtim. Ky lloj i komunikimit në klasë përfshin mjete të komunikimit me gojë, me shkrim dhe me anë të mjeteve pamor.³³

Komunikimi si një raport sa objektiv dhe subjektiv që vendoset mes dhënësit dhe marrësit të mënyrës se si komunikojmë me fëmijët është shumë e rëndësishme, për aq kohë sa luan një rol vendimtar në formimin e personalitetit të tyre. Ne komunikojmë me nxënësit nëpërmjet fjalëve, nëpërmjet gjuhës, lëvizjeve të trupit dhe vështrimeve.

³² Soares, Fredson & Da Luz, Reis (2015). The Relationship between Teachers and Students in the Classroom: Communicative Language Teaching Approach and Cooperative Learning Strategy to Improve Learning. fq 7-13.
<https://pdfs.semanticscholar.org/9152/1c4b584eed94fcc6b47f49d2004b271f6373.pdf>

³³ Musai, Bardhyl. (2003). Metodologji e mësimdhënies e mësimnxënies. Fq. 227-228

Kur një nxënës apo fëmijë është i frikësuar, e mira është të pranojmë frikën e tij hapur dhe me respekt. Më e mira është që mësuesi të dëgjojë problemin, ta riformulojë dhe qartësojë atë dhe më pas të pyes: “Çfarë mundësish dhe alternativash ke përpara teje”. Shumë shpesh ndodh që një nxënës e ka ose e gjen një zgjidhje. Në këtë mënyrë ai mëson se si mund të mbështetet në gjykimet e veta. Kur një mësues nxitimthi ofron një zgjidhje, nxënësit humbasin mundësinë të bëhen të aftë për zgjidhjen e problemeve dhe të kenë besim te vetja. Është më e lehtë të arrish bashkëpunimin me nxënësit duke ndryshuar gjendjen e tyre se sa duke ndryshuar mendjen e tyre.

Komunikimi efektiv me një nxënës është gjithashtu edhe një themel i fortë për diciplinën e mirë dhe bashkëpunim të mirë. Në mënyrë që të egzistojë bashkëpunimi në komunikimin e mësuesit me nxënësit, mesazhet duhet të përcjellin tek nxënësi ndikimin që ka sjellja e tyre.

Si rregull mesazhet duhet të:

- Pranojnë qartësisht qëndrimin e nxënësit apo mendimin e tij.
- Nuk duhet të mohojnë perceptimin e nxënësit.
- Nuk duhet të vënë në diskutim ndjenjat e nxënësit-çdo nxënës duhet kuptuar ndjenjat e tij.
- Nuk duhet të mohojnë dëshirat e tij – t’iu dëgjoen dëshirat e tyre në shkollë.
- Nuk duhet të injorojnë shijet e tij.
- Nuk duhet të denigrojnë opinionet e nxënësit.
- Nuk duhet të zhvlerësojnë karakterin e tij.
- Nuk duhet të denigrojnë personalitetin e tij.³⁴

³⁴ Gixharri, Aurora. (2016). Metodatat efektive për mësim. Fq.23,32,33,36.

2.1.5. Të mësuarit bashkëpunues

Angazhimi i prindërve në mësim është i duhur për të rritur më shumë suksesin e nxënësve. Shkolla dhe mësuesit mund të mbështesin angazhimin e prindërve, duke ndërtuar bashkëpunim për të lidhur mësimin në shtëpi dhe në shkollë. Zakonisht prindërit mund të fokusohen në aktivitete të bazuara në shkollë, siç janë ndjekja e ngjarjeve ose vullnetarizmi në klasë.³⁵

Prindërit dhe mësuesit kanë një rol shumë të rëndësishëm në ndërtimin e vullnetit të fëmijëve për të mësuar. Përfshirja e prindërve është në gjendje të motivojë dhe të promovojë vetëbesimin e nxënësit. Kjo çështje inkurajon nxënësit për të mësuar. Pjesëmarrja e prindërve apo vendimmarrja e prindërve në shkollë, fuqizon mbështetjen e fëmijëve të tyre në procesin e të mësuarit.³⁶ Bashkëpunimi midis mësuesit dhe prindit nuk është i lehtë për tu mbajtur, por është thelbësor për procesin arsimor. Prindërit mund të marrin pjesë aktive duke bashkëpunuar me mësuesin në të mësuarit e fëmijës, duke kontrolluar shënimet e dërguara nga mësuesi, duke folur me fëmijën e tyre rreth shkollës, të mësuarit.³⁷

Të mësuarit bashkëpunues konsiderohet një qasje edukative premtuese nga perspektivat të ngarkesës njohëse dhe të të nxënësve konstruktiv. Mësuesit shpesh përballen me sfida gjatë strukturimit të aktiviteteve bashkëpunuese si, monitorimin e sjelljes së nxënësve në detyrë, menaxhimin e kohës së punës në grup, sigurimin e relevantes materialet, caktimin e roleve individuale dhe krijimin e besimeve dhe sjelljeve të punës në grup. Nëse mësuesit, për shembull, nuk janë të sigurt për mënyrën e monitorimit të diskutimeve të grupeve të nxënësve dhe ndërhyjnë në mënyrë adekuate kur të jetë e nevojshme, ose krijojnë sjellje të përshtatshme bashkëpunuese, kjo ndoshta do të ndikojë në cilësinë e bashkëpunimit³⁸

³⁵ Australian Government, department of education. <https://www.education.gov.au/parent-engagement-learning-0>

³⁶ Wulandary, Dwi & Herlisa (2017). Parent Involvement in Schooling Processes: A Case Study in an Aceh School. fq. 12. <https://trepo.tuni.fi/bitstream/handle/10024/102137/GRADU-1507560787.pdf?sequence=1>

³⁷ Ministry of education, Guyana. <https://www.education.gov.gy/web/index.php/teachers/tips-for-teaching/item/2482-relative-roles-of-parents-teachers-in-bringing-up-a-child>.

³⁸ Ha Le, Jenssen Jeroen & Wubbels Theo. Collaborative learning practices: teacher and student perceived obstacles to effective student collaboration. fq. 2-3. <https://sci-hub.tw/10.1080/0305764X.2016.1259389>

Mësuesi duhet të ketë ekspertizë të mjaftueshme pedagogjike për të realizuar me sukses të mësuarit bashkëpunues. Qëndrimet e mësimeve ndaj mënyrave të duhura të punës, të tilla si dhënia e inkurajimit dhe lirisë, si dhe lejimi i marrjes së rrezikut dhe bashkëpunimit, mund të përgatisin dhe lehtësojnë kreativitetin e nxënësve. Mësuesit mund të aplikojnë mënyra të mësimeve që rrisin autonominë dhe lirinë e ndërtimit të njohurive të nxënësve gjatë punës, dhe të cilat lejojnë kohë të mjaftueshme për të menduarit kreativ dhe proceset e bashkëpunimit.³⁹

Të nxënit në bashkëpunim merr shumë forma brenda klasës. Karakteristika e tij thelbësore është se ai ndihmon në vartësinë e brendshme pozitive, nëpërmjet të nxënit të nxënësve, që të mësojnë dhe të punojnë bashkë në njësi grupesh të vogla. Të nxënit në bashkëpunim ofron shumë përfitime: të nxënësit ai përmirëson të nxënit e njohurive dhe shprehjet sociale. Të mësuesit ai është një ndihmë në drejtimin dhe udhëzimin e klasës, mësuesit mund të përfitojnë nga të nxënit në bashkëpunim në aspektin e drejtimit të klasës. Mësuesi mund të rritë kohën e të nxënit të nxënësit dhe të zvogëlojë nivelin e stresit dhe të ngarkesës së punës së tij, duke i mësuar nxënësit të ndihmojnë njëri-tjetrin në detyrat e të nxënit dhe të organizimit, duke i aftësuar gjithashtu, të kontrollojnë përparimin e njëri-tjetrit.⁴⁰

Kur mësuesi merr vendim për ta përdorur organizimin e të mësuarit bashkëpunues për një përmbajtje apo veprimtari të veçantë, i ka në konsideratë katër parakushte themelore të domosdoshme, të cilat lejojnë një nxënie bashkëpunuese:

1. A nevojitet të nxënit verbal (diskutime) për një veprimtari mësimore?
2. A mund të mësojnë nxënësit atë përmbajtje nga njëri-tjetri(interaksioni)?
3. Diskutimi nxënës me nxënës a do të jetë i dobishëm (bashkëpunimi)?
4. A janë rezultatet e pritura special dhe akademike (niveli) të dëshiruara?

³⁹ Rajja, Hämäläinen&Vähäsantanen, Katja. (2011). Theoretical and pedagogical perspectives on orchestrating creativity and collaborative learning. fq 14-15 https://www.researchgate.net/profile/Raija_Haemaelaen/publication/230649501_Theoretical_and_pedagogical_perspectives_on_orchestrating_creativity_and_collaborative_learning/links/5a38dec3458515919e727a10/Theoretical-and-pedagogical-perspectives-on-orchestrating-creativity-and-collaborative-learning.pdf.

⁴⁰ Musai, Bardhyl. (2003). Metodologjia e mësimeve. fq 278-279.

Pasi që mësuesi merr vendim ta praktikojë organizimin e të mësuarit bashkëpunues, gjithashtu ai ka në konsideratë edhe planifikimin e sjelljeve dhe vlerësimin e procesit të të nxënit bashkëpunues në klasë. Kjo mund të ndahet në tri pjesë:

- Përgjegjësia individuale: mësuesi parasheh që çdo nxënës të marrë përgjegjësi të dijë çfarë duhet të bëjë vetë dhe çfarë të arrijë.
- Përgjegjësia e grupit: mësuesi duhet të ndërtojë një procedurë që lejon konstatimin e nivelit të bashkëpunimit të grupit. Që do të thotë vlerësohet grupi e jo individi.
- Vlerësimi i procesit: mësuesi i ndihmon të gjithë grupet e vogla që të analizojnë sesi u zhvilluan proceset në mënyrën e të mësuarit bashkëpunues, gjithmonë në mënyrë që ata ndërkojnë t'i përmirësojnë përfundimet.⁴¹

2.2. Bashkëpunimi prind-mësues

Bashkëpunimi me prindër në forcimin e rolit edukativo-arsimor të shkollës, si dhe ngritjen e efikasitetit të plotë të punës mësimore, luan rol me rëndësi në këtë drejtim. Prindërit si faktor me rëndësi në procesin e edukimit dhe arsimit të fëmijëve kanë rol të shumëfishtë, ku roli i tyre manifestohet në punën e suksesshme të nxënësit në klasë. Bashkëpunimi mes shkollës dhe familjes është çështje e domosdoshme, duhet të jetë i planifikuar dhe pjesë e programit të shkollës dhe kujdestarit të klasës.⁴²

Detyra menaxhimit të klasës lehtësohet, kur mësuesi ka lidhje të ngushta dhe të sinqerta me prindërit. Lidhjet më të zakonshme prindër mësues, fillojnë me kujdesin për të bërë mbledhje të rregullta dhe të frytshme me prindërit dhe vazhdojnë me informimin konstant të tyre.⁴³

Mënyrat më të mira për mësuesit që ti ndihmojnë prindërit rreth arritjes së suksesit të nxënësve janë:

⁴¹ Zajazi, Tahir. (2003). Metodologji. Të më mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mësimi kooperues. Fq. 422,423,424.

⁴² Zylfiu, Nijazi. (2000). Didaktika. Fq. 135-36.

⁴³ Garo, Sofokli. (2013). Teoria dhe praktika e mësimdhënies. Fq. 255,

- Komunikoni-pasi që komunikimi është çelësi dhe mbajtja e prindërve në edukimin e fëmijës së tyre. Sa më shumë që komunikojnë aq më i mirë është sukcesi i fëmijëve.
- Edukimi i tyre – mësoni si ti mësojnë fëmijët e tyre, pasi që ata duhet të mbështesin të mësuarit në shtëpi.
- Jini pozitiv–dërgoni një mesazh apo email , për t’ua bërë të ditur gjërat e mrekullueshme që po bën fëmija .

Për ta ndihmuar prindërit mësuesin rreth arritjeve të nxënësve ekzistojnë tri mënyra më të mira, pasi që përveç që mësuesit i ndihmojnë prindërit edhe prindërit mund të ndihmojnë mësuesit, duke informuar rreth zhvillimit të fëmijëve në shtëpi.

- Përfshihuni në edukimin e fëmijës tuaj-tregojuni atyre se ju interesoheni dhe krijoni marrëdhënie pozitive me mësuesit.
- Edukoni veten mbi tendencat aktuale në arsim- është detyrë e juaja të ballafaqoheni me mënyrat e reja në arsim.
- Dërgoni fëmijët në shkollë të lumtur- jepuni fëmijës suaj një përqafim, tregoni sa i doni pasi që ata do të jenë më të sigurt për të filluar një ditë pozitive.⁴⁴

Bashkëpunimi prind–mësues duhet të ekzistojë në çdo shkollë. Përveç marrëdhënieve që ka mësuesi me nxënësit, përfshihen edhe marrëdhëniet me prindërit e nxënësve, të cilat janë mjaftë të rëndësishme për të pasuruar ndërveprimin mësimdhënie-mësimnxënie. Përmirësimi i marrëdhënieve me prindërit nuk ndodh thjesht për faktin se shkolla ofron veprimtari në të cilën ftohen prindërit. Mësuesi kanë nevojë t’i takojnë” atje ku ata ndodhen”.⁴⁵

Sipas kërkimeve të gjetura bashkëpunimi mësues-prind mundë të arrihet vetëm duke i përfshirë prindërit në shkollë për suksesin e nxënësve, duke ndërvepruar mësuesit dhe prindërit.

⁴⁴ Craig,Kemp.(2015).The parent-teacher-student relationship. <http://mrkempnz.com/2015/08/the-parent-teacher-student-relationship.html>

⁴⁵ Musai, Bardhyl. Psikologji edukimi (1999). Fq. 30.

2.2.1. Ndërveprimi prind mësues mund të realizohet duke marrë këshillat për mësuesit:

Bashkëpunimi prindër mësues mund të arrihet duke ndërvepruar me njëri tjetrin rreth edukimit të fëmijëve. Bashkëpunimi mësues–prindër varet nga mënyra si ndërveprojnë me njëri –tjetrin. Ndërveprimi mësues-prindër duhet të jetë në mënyrë sa më pozitive, të informohen prindërit për çdo gjë rreth edukimit në shkollë, rreth ecurisë së fëmijëve.

1. Komunikoni me prindërit në mënyrë proaktive

Prindërit e nxënësve me të vërtetë duan të jenë të përfshirë në arsimimin e fëmijëve të tyre. Prandaj, është e rëndësishme të mos supozohet që prindërit nuk duan të "shqetësohen" me një çështje që ka të bëjë me fëmijët. Kur del diçka, qofshin çështje të sjelljes ose një shqetësim akademik, jini proaktive në lidhje me kontaktimin e prindit menjëherë. Në fakt, kjo mund të bëhet më e lehtë duke marrë kohë për të mbledhur të gjitha informacionet e kontaktit të nxënësve në fillim të vitit shkollor. Në veçanti, do të duhet të keni adresë e-mail, për të gjithë prindërit e nxënësve, në mënyrë që të kontaktohen lehtë dhe shpejt sa herë që ka nevojë.

2. Komunikoni informacion pozitiv-Shpesh, prindërit dëgjojnë nga mësuesi i fëmijës së tyre vetëm kur ka ndonjë problem. Mësuesit mund të zhvillojnë një reputacion mjaft pozitiv si një profesionist i dashur dhe i mëshirshëm, vetëm duke marrë kohë për të kontaktuar tek prindërit e nxënësve për të ndarë mendimet pozitive në lidhje me performancën dhe rregullimin e shkollës. Për shembull, kur një nxënës në klasën fryn larg me një pasqyrë mbresëlënëse, do duhet të telefonohen në shtëpi për të ndarë historinë. Është e pabesueshme sa shpejt mund të fitohet besimi i prindërve, vetëm duke marrë kohë për të ndarë diçka pozitive që ata nuk mund ta dëgjonin ndryshe.

3. Krijoni një sistem për komunikimin e informacionit - Krijoni rutinat e komunikimit dhe sistemet që punojnë për ju, për të rritur ndërveprimet mësuesit me prindërit. Për shembull, zhvillohet një permbledhje e rregullt javore që mund të dërgohet në shtëpi nëpërmjet letër ose e-mail.

4. Planifikoni mbledhjet e rregullta prindërore- Kur keni një mbledhje me prindër ose takim, sigurohuni që të filloni me pozitivizëm. Pa marrë parasysh se çfarë lloj informacioni janë ftuar në klasën për të diskutuar, duhet të sigurohen mësuesit që ju t'u përcillen prindërve mesazh se

vlerësohen fëmijët e tyre në veçanti dhe që njohin diçka rreth tyre që i bën ata të veçantë. Çdo prind dëshiron të dijë se mësuesi i fëmijës së tyre me të vërtetë "i sheh" ata!

5. Plani për ndërveprimet e prindërve-mësueseve - Në vend që të bëhen të frustruar nga nevoja për të kthyer telefonata të papritura gjatë orës së drekës, duhet të kuptohet se prindërit duhet që herë pas here të lidhen me mësuesit dhe mësuesit do të duhet të krijojnë kohë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre në ditën e punës. Kjo mund të nënkuptojë caktimin e "orëve të punës" para ose pas shkollës dhe duke u dëshmuar prindërve se jeni në dispozicion për të diskutuar.⁴⁶

Dr Maria Montessori besonte se "edukimi duhet të fillojë në lindje", pasi çdo fëmijë ka një mendje absorbuese, domethënë një mendje që mund të thithë fjalë për fjalë nga të gjitha ato që ai apo ajo has. Montessori u përqendrua në rëndësinë e jashtëzakonshme të gjashtë viteve të para të fëmijës si bazë për të gjithë të mësuarit e ardhshëm. Ajo shkroi: "Sa më shumë plotësohen nevojat e një periudhe, aq më e madhe do të jetë suksesi i ardhshëm". Kjo vendos automatikisht prindërit si mësuesit e parë dhe më të rëndësishëm të fëmijës së tyre. Roli i prindërve është i një rëndësie të madhe dhe ne mund të arrijmë potencialin e fëmijëve dhe zhvillimin e "gjithë fëmijës" vetëm me ndihmën e përfshirjes së prindërve. Përfshirja e prindërve mund të përkufizohet si pjesëmarrja e prindërve, në çdo aspekt të edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve nga lindja deri në moshën e rritur, duke pranuar se prindërit janë ndikimi primar në jetën e fëmijëve.⁴⁷

Për mësuesit, është e rëndësishme të kuptojnë rolin e prindërve rreth fëmijës, të inkurajojnë prindërit për pjesëmarrje në edukimin e fëmijës së tyre. Mësuesi mund të krijoj një urë lidhëse nga klasa në shtëpi duke i sugjeruar dhe informuar prindërit rreth zhvillimit të fëmijës në shkollë.

Për shembull, mësuesit:

- sugjerojnë që të lexohen libra në shtëpi apo aktivitete të mundshme për të bërë në fundjavë,
- dërgoni artikuj të shkurtër në shtëpi për aktivitetet e duhura zhvillimore ,

⁴⁶ Teacher certification. <http://www.teachercertification.org/a/parent-teacher-interactions.html>

⁴⁷ American Montessori public school. <http://www.americanpublicschool.com/content/role-parents-and-schools-developing-essential-21st-century-skills>

- lejoni fëmijët të marrin libra në shtëpi rreth asaj që bëjnë në shkollë. Librat mund të bëhen me fëmijët, rreth udhëtimeve në teren ose temave të zhvilluara në shkollë. Këto libra mund të bëhen nga vizatimet ose pikturat e fëmijëve me fjalët e tyre të diktuar nga mësuesi. Fëmijët mund të kthehen duke i sjellë në shtëpi,
- dërgoni në shtëpi raporte javore ose mujore për të ndihmuar lidhjen midis shtëpisë dhe shkollës. Kjo do t'i japë prindërve një ndjenjë të pritjeve të mësuesit për fëmijët dhe përpjekjet e tyre me fëmijët.⁴⁸

Rreth përfshirjes së prindërve në shkollë ka shumë hulumtime të bëra, pasi që përfshirja e tyre ndikon shumë në suksesin e nxënësve dhe ndihmon në bashkëpunimin mes prindërve dhe mësuesve. Sa më shumë që përfshihen prindërit në shkollë, aq më shumë angazhohen dhe shprehin interesim edhe prindërit për të bashkëpunuar me mësuesit si dhe ndihmojnë fëmijët në edukimin e tyre. Për këtë hulumtuesja Joyce L. Epstein, sugjeroi që sa më shumë të përfshihen prindërit në shkollë.

Joyce L. Epstein përfshirjen e prindërve ndau në 6 lloje:

1. Prindërimi:- Ndhmon familjet me aftësi për të rritur fëmijën, duke kuptuar zhvillimin e fëmijës dhe vendosjen e kushteve të shtëpisë që mbështesin fëmijët si nxënës në çdo moshë dhe nivel të klasës.
2. Komunikimi: komunikoni me familjet rreth programeve shkollore dhe zhvillimin e nxënësve, përmes lidhjes efektive nga shkolla në shtëpi dhe nga shtëpia në shkollë.
3. Vullnetarizmi: përfshinë familjet si vullnetarë në shkollë ose në të tjera vende. Lejon mësuesit të punojnë me vullnet të mbështesin nxënësit dhe shkollën.
4. Mësimi në shtëpi- Përfshin familjet me fëmijët e tyre në mësimin akademik në shtëpi, duke përfshirë detyrat e shtëpisë, përcaktimin e qëllimeve dhe programet e tjera, që lidhen me kurrikulën.

⁴⁸ Loughran, Sandra B.(2008).The importance of teacher-parent partnerships: preparing pre- service and in- service teachers.fq,36. <file:///C:/Users/x@y/Downloads/1239-Article%20Text-4907-1-10-20110112.pdf>

5. Marrjen e vendimeve- Përfshirja e familjeve si pjesëmarrës në vendimet shkollore, qeverisjes dhe aktiviteteve, nëpërmjet këshillave të shkollës ose ekipet e përmirësimit dhe organizatat prindërore.

6. Bashkëpunimi me komunitetin-Koordinon burimet dhe shërbimet për familjet, nxënësit dhe shkollën me grupet e komunitetit.⁴⁹

Kur prindërit dhe mësuesit punojnë së bashku angazhohen së bashku sigurisht që edhe nxënësit do të arrijnë suksese më të larta. Bashkëpunimi prindër mësues mund të arrihet duke i informuar prindërit në kohë, duke komunikuar me prindër, përmes mbledhjeve në shkollë.

2.2.2. Mbledhjet prindër- mësues

Lidhjet më të zakonshme prindër- mësues fillojnë me kujdesin për të bërë mbledhje të rregullta dhe të frytshme. Mbledhjet me prindër, lejojnë mësuesin dhe prindërit të diskutojnë për nxënësin ballë për ballë, shërben si mjet që heq çdo keqkuptim të mundshëm të ardhur nga letrat apo informacionet për rreth. Është një mundësi që i jepet prindit për të bërë pyetje dhe sugjerime, është një rast që shfrytëzohet nga mësuesi, për të marrë më shumë të dhëna nga prindi dhe për të plotësuar gjërat që s'janë thënë në letra, etj. Në mbledhje duhet të bërë kujdes në disa gjëra:

- Të planifikojmë atë që duam të themi dhe mënyrën si të zhvillohet mbledhja.
- Të jemi të këndshëm, të sjellshëm dhe të durueshëm.
- Të jemi të qartë, të sigurohemi se prindërit kuptojnë duke përdorur gjuhë të thjeshtë pa fjale të mëdha.
- Të evitohen kritikrat për mësuesit tjerë dhe drejtorinë.
- Bashkëpunimin me prindër duhet të kërkohet me ngulm.

Për mbledhjet prind- mësues duhet përgatitur një rend dite, në mënyrë që të inkurajojnë prindërit për pjesëmarrje. Ky rend dite duhet që të bëhet i njohur që më përpara. Në mbledhje duhet të raportohet mbi ecurinë e fëmijës, ku këto raporte mund të shëdrohen në mjet

⁴⁹ Epstein, Joyce L. Sanders, Mavis G. Simon, Bath S. Salinas, Karen Clark. Jansorn, Natalie Rodriguez. Van Voorhis, Frances L. (2002). School family and community partnerships. Fq. 165. <https://www.govinfo.gov/content/pkg/ERIC-ED467082/pdf/ERIC-ED467082.pdf>

kunikimi të dyanshëm nëse edhe prindërit raportojnë mbi progresin që fëmija bën në shtëpi në lidhje me çështjet e tilla:

- Vullneti për t'i bërë detyrat e shtëpisë ;
- Leximet jashtëshkollore;
- Reduktimi i kohës kushtuar televizorit;
- Qëndrimi ndaj të mësuarit;

Këto raporte mund të jenë mjet shprehje për prindërit ndaj shqetësimeve që ata mundë të kenë, si dhe janë një mënyrë për të kërkuar një takim.⁵⁰ Mbledhjet apo edhe takimet mundë të ndihmojnë mësuesin dhe prindërit që të rrisin suksesin e nxënësve.

Mbledhja e mësuesve dhe prindërve luajnë një rol vendimtar në rritjen e edukimit të fëmijës. Takimi mësues- prindër është një mënyrë efektive për prindërit dhe mësuesit për të bashkëvepruar dhe për të diskutuar për përparimin e fëmijës së tyre. Prindërit në anën tjetër mund të luajnë një rol aktiv në edukimin e fëmijës së tyre dhe mund të inkurajojnë dhe ndikojnë më tej në fëmijën e tyre për tu zhvilluar mirë në shkollë.

Takimi i mësues- prindër është një mënyrë efektive përmes së cilës prindërit mund të diskutojnë disa çështje që ata mendojnë se po pengojnë të mësuarit e fëmijës së tyre. Komunikimi ballë për ballë me mësuesin i ndihmon jashtëzakonisht prindërit të planifikojnë procesin e mësimit të fëmijës së tyre. Nga ana tjetër, mësuesin gjithashtu marrin kuptojnë më shumë rreth personaliteteve të përgjithshme, pëlqimeve, mosveprimeve, forcës dhe dobësive të nxënësve të tyre, gjë që është e mundur vetëm nëpërmjet takimit të mësuesve dhe prindërve. Prindërit mund të informojnë mirë mësuesit për fëmijët e tyre. Në bazë të informacionit të dhënë nga prindërit edhe mësuesit mund të bëjnë disa modifikime dhe të gjejnë mënyra të reja për t'i bërë studentët të kuptojnë dhe të mësojnë në mënyrë më efektive.⁵¹

Takimet prindër-mësues mund të ndihmojnë në zhvillimin e një partneriteti të suksesshëm midis prindërve dhe mësuesve, një aspekt i rëndësishëm i arritjeve akademike dhe sociale të fëmijës. Mësuesit dhe prindërit mund t'i përdorin këto momente për të krijuar një

⁵⁰ Brophy, Jere. (2003) Mësimdhënia. Fq. 51. Doracak për arsimtarët. Unesco

⁵¹ Meenakshi world school. (2017). How parent teacher meeting play a significant role in child development. <https://www.meenakshiworlidschool.com/blog/34-how-parent-teacher-meeting-play-a-significant-role-in-child-development>

raport dhe për të zhvilluar një synim të përbashkët që fokusohet në ndihmën për fëmijën që të ketë përvojën më të mirë shkollore të mundshme. Mësuesit shpesh i prezantojnë prindërve stilin e tyre të mësimdhënies, metodat e disiplinës dhe politikat e klasës në fillim të vitit përmes orientimit të prindërve dhe informacionit me shkrim. Një përbërës kryesor i takimit prind-mësues është shkëmbimi i informacionit me mësuesin lidhur me përparimin akademik dhe zhvillimin social të fëmijës.⁵²

Ngritja dhe takimi me prind ndihmonë në nxjerrjen e gjërave për një fillim të mirë. Dhe mësuesi mund të flas në mënyrë pozitive ose të përmend diçka të veçantë që ka bërë fëmiju atë ditë. Mësuesi duhet të bëjë diçka për të thyer idenë se prindërit duhet vetëm të ulen dhe dëgjojnë. Thuhet se sukseesi i një takimi apo mbledhje të prindërve, përcaktohet në minutat e para të takimit. Prindërit shpesh duhet të inkurajohen për të shkëmbyer informacione. Shumë prindër kanë një mendim se ata po shkojnë në një takim për të dëgjuar për fëmijën e tyre - jo për të dhënë informacion mësuesit për fëmijën e tyre. Mësuesi në takime duhet të shkojë apo të dalë i rregullt me një përgatitje të duhur për takim. Krijimi i disa rregullave bazë mund të zvogëlojë emocionalitetin dhe stresin e trajtimit të palëve, sidomos kur janë të zemëruar, pasi që mund të jenë edhe të zemëruar prindërit. Këto rregulla përfshijnë në vijim:

1. Përqendrohuni në çështje, jo në njerëz.
2. Lejo që dikush të flasë për një kohë të dhënë pa ndërprerje.
3. Hidhni një pyetje, vetëm kur të gjithë të pranishmit pajtohen që diskutimet e mëtejshme nuk janë të nevojshme.
4. Shënoni pikat e rëndësishme.
5. Përfshirja e të gjithë pjesëmarrësve në zgjidhjet e propozuara.
6. Kërkoni përgjigjen e prindërve në kohë të përshtatshme.⁵³

⁵² King, Sandra. (2017). What are three important components of parent-teacher conferences. <https://healthfully.com/214944-what-are-the-three-important-components-of-parent-teacher-conferences.html>

⁵³ Kroth, Roger L.&Edge, Denzil (2007).Parent-teacher conferences. Fq. 6. <https://sci-hub.tw/https://journals.ku.edu/FOEC/article/view/6828>. Volume 40. number 2.october 2007

Takimet prind-mësues janë një nga metodat më të zakonshme të bashkëpunimit. Mbledhjet thirren për një nga tre arsyt kryesore: administrative (p.sh., çështjet e vlerësimit ose të përshtatshmërisë); krizë situata (p.sh., veprimet disiplinore); dhe raportin e progresit rutinë, i cili zakonisht mbahet në fund të periudhave të notimit. Zbatimi i duhur i mbledhjeve mund të kontribuojë ndjeshëm në mbajtjen e një politike pozitive në shtëpi, aktivitetet e bashkëpunimit shkollor.⁵⁴

2.2.3. Informimi I prindërve

Derisa fëmijët janë në mes të trekëndëshit në shkollë, e drejtë e prindërve është të dinë të informohen nga mësuesi se si përparojnë fëmijët e tyre. Informimi i prindërve rrit bashkëpunimin mes mësuesit dhe prindërve si dhe ndikon pozitivisht mbi zhvillimin e fëmijëve në shkollë. Në veçanti çdo prind ka të drejtë të dijë:

1. Se sa mirë përparon fëmija në secilën lëndë .
2. Si krahasohet përparimi i fëmijës së tij me atë të nxënësve tjerë .
3. Cilat janë potencialet e tij apo tregon interesa ose dhunti të veçantë.
4. Çfarë vështirësish ka fëmija ?
5. Si sillet në shkollë?
6. Si i ka marrëdhëniet dhe komunikimin me nxënësit dhe mësuesit?
7. A ka ndonjë mënyrë që prindi ta ndihmojë fëmijën?
8. Në ç'mënyrë prindi mund të bashkëpunojë me mësuesin.⁵⁵

Në këtë mënyrë shkolla apo mësuesi mundë të bashkëpunojë me prindërit për të arritur suksesin e nxënësve. Për të ndihmuar komunikimin dhe informimin, mbani prindërit të përfshirë në çdo gjë që fëmija i tyre bën në shkollë. Duhet te mbahen prindërit të informuar për ngjarjet shkollore, procedurat në klasë, strategjitë arsimore, datat e caktimit, sjelljen, përparimin akademik ose çfarëdo që lidhet me shkollën.

⁵⁴ Patton, James R.& Jayanthi, Madhavi.& Polloway, Edward A.(2001). Home-school collaboration about homework: what do we know and what should we do?.fq 228. <https://sci-hub.tw/10.1080/10573560152121010>.

⁵⁵ Garo, Sofokli. (2013). Teoria dhe praktika e mësimdhënies. Fq. 256.

Sipas Janell Cox, mësuesit duhet ti informojnë prindërit dhe të komunikojnë në këto pika:

Shfrytëzoni teknologjinë - Teknologjia është një mënyrë e shkëlqyeshme për të mbajtur prindërit të informuar, sepse ju lejon të merrni informacion shpejt për shkollën.

Konferencat e prindërve - kontaktet ballë për ballë janë mënyra më e mirë për të komunikuar me dhe informuar prindërit dhe shumë mësues e zgjedhin këtë opsion si mënyrën e tyre kryesore për të informuar. Është e rëndësishme të jeni fleksibil kur planifikoni konferenca sepse disa prindër mund të marrin pjesë vetëm para fillimit ose pas mbarimit të shkollës.

Shtëpia e hapur - është një mënyrë tjetër për t'i informuar prindërit dhe për t'i bërë ata të ndjehen të mirëpritur. Jepni çdo prind me një paketë informacioni thelbësor që do t'i nevojitet gjatë gjithë vitit shkollor. Të informohen rreth programit shkollor pasi që kjo mundë të ndikoj mirë në zhvillimkin e fëmiut.

Raportet e progresit - mund të dërgohen në shtëpi javore, mujore ose disa herë në vit. Kjo mënyrë e lidhjes u jep prindërve dëshmi të prekshme të përparimit akademik të fëmijës së tyre.

Buletini mujor - është një mënyrë e thjeshtë për t'i informuar prindërit me informacione të rëndësishme.⁵⁶

⁵⁶ Cox, Janelle(2019).Parent-teacher communication. <https://www.thoughtco.com/parent-teacher-communication-2081926>.

2.2.4..Komunikimi prind-mësues

Komunikimi i shkollës me komunitetin e saj prindëror, është një nga aspektet apo veprimtaritë e shkollës, e cila ka qenë vazhdimisht në vëmendjen e specialistëve dhe kërkuesve të fushës së edukimit. Ky aspekt është konsideruar si i një rëndësie të veçantë, jo vetëm në kontekstin etik të detyrimit që një institucion shkollor ka për shërbimin që ofron, por edhe për faktin se komunikimi dhe bashkëpunimi mësues-prind, kur zhvillohet në mënyrë sistematike dhe strukturohet në mënyrë profesionale kthehet në një faktor favorizues për suksesin e fëmijës/nxënësit, i cili në fakt është sukses jo vetëm i nxënësit, por edhe i shkollës dhe familjes. Fëmija në pjesën më të madhe të kohës është i ekspozuar dhe ndërvepron me dy mjedise të mëdha, me shkollën dhe familjen. Ndërtimi i një raporti pozitiv të komunikimit mësues – nxënës, i tillë që të nxitë sjellje të mira dhe të parandalojë sjelljen jo të mirë, kërkon edhe përfshirjen e prindërve në shkollimin e fëmijëve.

Interesimi i prindërve ka një efekt pozitiv në rezultatet e fëmijëve dhe është sinjali më i saktë për një sukses të nxënësit në shkollë.

Disa nga përfitimet që ka interesimi i familjes janë: nxënësit arrijnë rezultate më të mira, pavarësisht nga gjendja e tyre sociale ekonomike, prejardhja e tyre etnike apo raciale, nga arsimi që kanë prindërit.

- Nxënësit ndjekin shkollën rregullisht.
- Nxënësit i bëjnë detyrat më rregull.
- Nxënësit shfaqin qëndrime e sjellje më pozitive.

Zakonisht, komunikimet prind - mësues ose prind - mësues -nxënës mbahen për disa arsye:

- (a) për të diskutuar për çështje të veçanta mësimore, siç është ecuria në mësimet e fëmijës.
- (b) ose për t'u kërkuar ndihmë prindërve në klasë apo në shkollë;
- (c) për të diskutuar frekuentimin e fëmijës në shkollë apo çështje të disiplinës;

(d) për të diskutuar çështje që ngrenë vetë prindërit;

(e) për të zhvilluar një takim të zakonshëm, siç parashikohet në kalendarin shkollor.⁵⁷

Nxënësit arrijnë rezultate më të larta nëse prindërit dhe mësuesit i kuptojnë objektivat e njëri tjetrit dhe mbajnë kontakt të vazhdueshme në lidhje me mënyrën e të studiuarit të fëmijës, qëndrimet e tij në shkollë, marrëdhëniet shoqërore dhe ecurinë në shkollë. Komunikimi mes shkollës dhe shtëpisë është më efikas kur rrjedh nga të dyja drejtimet dhe shkolla duhet të dijë të dallojë mes përpjekjeve për t'i informuar prindërit dhe mundësive për të komunikuar me prindërit.⁵⁸

Komunikimi me prindërit është i një rëndësie të madhe. Mësuesit duhet të jenë të përgatitur për të punuar me një shumëllojshmëri të prindërve. Në një mjedis të hershëm të fëmijërisë, një mësues zakonisht sheh disa prindër më shumë se të tjerët, por të gjithë prindërit kanë nevojë dhe duan të dinë se çfarë po ndodh me fëmijën e tyre. Për shkak të diversitetit midis prindërve dhe mësuesëve për të komunikuar më mirë me secilin prind, është e nevojshme të:

- komunikoni shkurtimisht dhe në mënyrë të qartë. Organizoni mendimet tuaja përpara kohe, shqyrtoni mesazhet me shkrim.
- bëni të qartë për secilin që ai ose ajo respektohet dhe pjesëmarrja e tij ose saj është e inkurajuar
- të jetë fleksibël, duke inkurajuar prindërit që punojnë për të marrë pjesë aktive dhe të përfitimit.⁵⁹

Mësuesit e suksesshëm janë ata që i konsiderojnë bashkëpunëtorë prindërit dhe miq në programin e edukimit të fëmijëve. Si një aspekt i rëndësishëm në edukimin e fëmijëve, komunikimi me prindër - mësues mund të:

- sigurojë një lidhje midis përvojave në shtëpi dhe programit të edukimit.
- Ndihmoj prindërit të rrisin kuptimin e tyre për zhvillimin e fëmijës në fushat e zhvillimit fizik, social, emocional dhe kognitiv.

⁵⁷ Gixharri, Aurora (2016).Metodat efektive te komunikimit në mësimdhënie. Fq. 43,44,45.

⁵⁸ Brophy, Jere. (2003). Mësimdhënia. . 51. Doracak për arsimtarët. unesco

⁵⁹ Lougrahn, Sandra B. (2008). The Importance Of Teacher/Parent Partnerships: Preparing Pre-Service And In-Service Teachers fq 35. Journal of College Teaching & Learning – August 2008 Volume 5, Number 8.
<https://clutejournals.com/index.php/TLC/article/download/1239/1223>

- Përfshijë prindërit në vlerësimin, zbatimin dhe vlerësimin e rritjes dhe zhvillimit të fëmijës.
- Përforon aftësinë e prindërve për të siguruar një mjedis të mirë dhe emocionues për familjen nëpërmjet akomodimit të aktiviteteve prind-fëmijë.
- Ndihmon prindërit të mësojnë për resurset që u janë ofruar atyre sipas nevojës (programet ushqimore, shërbimet mjekësore, këshillimet etj)
- Ndërtoni një partneritet të punës midis prindërve dhe mësuesit.

Prindërit janë ndikimi më i rëndësishëm në jetën e fëmijës dhe programi i fëmijërisë së hershme duhet të organizojë strategji dhe metoda që ndërtojnë partneritete pune. Një mësues i mirë, mësues-prind partneriteti fillon me komunikim të ndershëm, të besueshëm dhe të sinqertë. Mësuesit dhe prindërit mund të komunikojnë dhe punojnë së bashku në shumë mënyra.⁶⁰

2.2.5. Bashkëpunimi prind mësues përmes detyrave të shtëpisë

Një detyrë është një punë që duhet bërë në shtëpi, në shkollë ose në mjedisin komunitar dhe bazohet në njohuritë e marra që më parë në shkollë. Që detyra të kryhet mirë nga nxënësi, punën duhet ta fillojë mirë mësuesi. Ai duhet ta prezantojë atë në mënyrë të mjaftueshme. Për detyrën që jepet në shtëpi rekomandohet gjithmonë asaj ti paraprijë instruktimi, i cili shërben si premisë për përgatitjen e detyrës. Mësuesi s' do të jetë i pranishëm kur nxënësit ngecin në detyra, prandaj së pari nxënësit duhet të motivohen. Mësuesit në këtë pikë duhet të bashkëpunojnë ngushtë me prindërit. Rolin dhe rëndësinë që ka në përgjithësi detyra e shtëpisë duhet ta dijë jo vetëm nxënësi, por edhe prindërit.⁶¹

Detyrat e shtëpisë u mundëson mësuesve të krijojnë lidhje shkollë shtëpi . Detyrat përmirësojnë kuptimin e prindërve për atë që fëmijët e tyre po mësojnë, nxisin biseda pozitive në

⁶⁰ Gelfer, Jeffrey.I. Teacher -Parent Partnerships Enhancing Communications. fq. 164-165. <https://sci-hub.tw/10.1080/00094056.1991.10521602>

⁶¹ Garo, Sofokli. (2013). Teoria e mësimdhënies dhe mësimnxënies.fq,74,77,80.

shtëpi rreth punës shkollore dhe nëse është mirë zbatohen, përmirësojnë përfundimin e detyrave të nxënësve, lëndën aftësitë dhe gatishmërinë për klasë.⁶²

Detyrat e shtëpisë nuk janë caktuar vetëm për t'i mbajtur fëmijët të zënë në shtëpi. Detyrat e shtëpisë ofrojnë një mundësi për fëmijët që të zhvillojnë vetëdisiplinimin, zakonet e studimit dhe aftësitë e menaxhimit të kohës. Detyrat e shtëpisë janë një urë midis shkollës dhe shtëpisë. Mësimi duhet të ndodhë në shtëpi, si dhe në shkollë. Prindërit mund të ndihmojnë fëmijët të kenë sukses në detyrat e shtëpisë. Vendosja e një kohe specifike çdo ditë mund të bëjë detyrat e shtëpisë pjesë të rutinës së përditshme të fëmijës. Nëse detyrat janë të paqarta, komunikoni me mësuesin dhe bëni pyetje. Më e rëndësishmja, prindërit duhet të japin inkurajim për fëmijët e tyre. T'iu trregojnë fëmijëve se sa e rëndësishme është detyra e shtëpisë duke marrë një interes në të.⁶³

Edhe pse ka mendime se detyrat e shtëpisë janë pengesë për fëmijët, megjithatë ka shkrime se detyrat e shtëpisë apo puna e shtëpisë janë gjë e mirë për të marrë arsimimin e duhur.

Pesë arsye pse duhet të kenë detyra shtëpie janë:

1. Detyrat e shtëpisë ndihmojnë fëmijët dhe mësuesit të bashkëpunojnë-pasi në detyrat e shtëpisë mund të diskutojnë prindërit me fëmijët rreth rezultateve.
2. Detyrat e caktuara për fëmijët i bëjnë familjet më të afërta – pasi që fëmijët kur ndihen të pasigurt për një detyrë shtëpie pyesin prindërit për këshillë.
3. Praktika e bën të përsosur-shkrimi apo ndonjë detyrë tjetër e dhënë u ndihmon nxënësve të përgatiten më shumë.
4. Detyrat e shtëpisë i bëjnë studentët më të përgjegjshëm-duke e ditur se detyra ka një afat të caktuar, nxënësit do të bëhen më të përgjegjshëm si dhe më vullnetar, më planifikues për kohën.

⁶² Epstein, Joyce L. Sanders, Mavis G. Simon, Bath S. Salinas, Karen Clark. Jansorn, Natalie Rodriguez. Van Voorhis, Frances L. (2002). School family and community partnerships. Fq. 289. <https://www.govinfo.gov/content/pkg/ERIC-ED467082/pdf/ERIC-ED467082.pdf>

⁶³ <http://www.lacooperativa.org/parent-family-involvement-creates-success-school/>

5. Ndhimojnë prindërit të mbajnë gjurmët e performancës së tyre- duke i parë fëmijët u jep prindërve ndjenjën e nivelit të arsimimit të tyre.⁶⁴

Sipas Jere Brophy detyrat e shtëpisë janë si një stol trekëmbësh, detyrat e shtëpisë kanë nevojë për një mësues që i jep dhe që orienton nxënësit mbi zgjidhjen e tyre, një prind që mbikëqyrë detyrën dhe një nxënës që e zgjidh atë. Nëse njëra nga këmbët është e dobët stoli mund të rrëzohet. Roli i mësuesit që jep orientime, që rikonforcon atë që është bërë mirë dhe rishpjegon atë që nuk është kuptuar, është kyç në maksimizimin e impaktit pozitiv të detyrave të shtëpisë.⁶⁵

Roli simbolik i detyrave të shtëpisë është rivlerësuar nga studiues të ndryshëm Holmes dhe Croll (në Patton, James R. & Jayanthi, Madhavi. & Polloway, Edward A.), i cili vuri në dukje se detyrat e shtëpisë ofrojnë një lidhje të dallueshme mes shtëpisë dhe shkollës dhe u ofron prindërve mundësinë për të ushtruar dhe ofruar ndihmë në shkollë. Në disa situata familjare, për shumë arsye, si koha dhe disponueshmëria, detyrat e shtëpisë mund të jenë e vetmja mënyrë që prindërit të mund të lidhen me përvojat e shkollës së fëmijëve të tyre, ose të paktën të njihen me shkollën e fëmijëve të tyre.⁶⁶

⁶⁴ <https://college-homework-help.org/blog/homework-pros-and-cons>

⁶⁵ Brophy, Jere.(2003). Mësimdhënia. Doracak për arsimtarët. unesco. fq 74.

⁶⁶ Patton, James R. & Jayanthi, Madhavi. & Polloway, Edward A.(2001). Home-school collaboration about homework: what do we know and what should we do?.fq 229//. <https://sci-hub.tw/10.1080/10573560152121010>. Reading & Writing Quarterly, 17: 227-242, 2001 Copyright # 2001 Taylor & Francis 1057-3569 /01 \$12.00 + .00

KAPITULLI III

Qëllimi i hulumtimit

Bashkëpunimi mes mësuesit, nxënësit dhe prindit është thelbësore për zhvillimin e nxënësve në shkollë.

Hulumtimi i kësaj teme ka për qëllim identifikimin e marrëdhënieve mësues-nxënës, mësues-prind si dhe prind –fëmijë. Si janë raportet në këtë bashkëpunim dhe si ndikon ky bashkëpunim në procesin mësimor të nxënësve.

Studimi synon të masë bashkëpunimin në disa shkolla fillore në Bujanoc, pasi që bashkëpunimi në këtë trekëndësh ndikon në rritjen e suksesit të nxënësve.

Në këtë hulumtim është hulumtuar mbi punën e mësuesit me nxënësit gjatë procesit mësimor, tipi i tij, komunikimi me nxënësit, afërsia me nxënës, gadishmëria për të punuar edhe kur kanë ngecje në mësim.

Si qëllim tjetër ishte edhe bashkëpunimi me prindër si:

- Sa janë të interesuar për takim prindërit me mësuesin?
- Sa janë të interesuar për ecurinë e fëmijët të tyre në shkollë?
- Sa përfshihen prindërit në shkollë nga mësuesi?

Hipoteza

Bashkëpunimi mësues –nxënës-prindër rrit efikasitetin e mësimit dhe përgatitjen kompetent të nxënësve.

Metodologjia e hulumtimit

Për realizimin e këtij hulumtimi: Bashkëpunimi prind–mësues-nxënës në shkollat fillore të komunës së Bujanocit është përdorur metoda sasiore: në formën e pyetësorëve.


Popullsia e studimit përfshinë mësuesit, prindërit dhe nxënësit në tri shkollat fillore të komunës së Bujanocit në klasat nga e treta deri në të tetën.

Madhësia e kampionit: për të realizuar këtë hulumtim janë ndërtuar tre pyetësor: për prindër (90), mësues(45) dhe nxënës (90), ku gjithsej morën pjesë 225 të anketuar.

KAPITULLI IV

4.1. Analiza e të dhënave


Pyetësi për prindër



Grafiku nr.1

Lidhur me pyetjen se gjatë orës mësimore flet vetëm mësuesi kur shpjegon dhe nxënësit nuk mund të shprehin mendimin të bashkëpunojnë, rezulton se 31.11% të prindërve mendojnë se asnjëherë nuk flet vetëm mësuesi, ndërsa 22.22% se rrallë vetëm mësuesi flet gjatë orës mësimore, 10,00% të prindërve nuk e dinë sesi janë fëmijët e tyre në klasë me mësuesin dhe sa flet vetëm mësuesi, 13.33% mendojnë se kjo ndodhë shumë here që vetëm mësuesi flet, ndërsa 23.33 e prindërve janë përgjigjur se gjithmonë aty flet vetëm mësuesi dhe jo fëmijët


Fëmi im është i lirë të flasë me mësuesin për të gjitha problemet



Grafiku nr. 2


Lidhur me lirinë e nxënësve për t'i shprehur të gjitha problemet me mësuesin sipas prindërve rezulton se; 10% e tyre “asnjëherë” nuk janë të lire të flasin në rast se kanë problem në shkollë, 14% e tyre “rrallë” mund të jenë të lire kurse 10% e prindërve shprehen se “nuk e di” ,26% prindërve shprehen se “shumë rrallë” mund të jenë të lire dhe 40% e prindërve shprehen se “gjithmonë” janë të lire te flasin rreth problem ne rast se kanë. Nga kjo vërejmë se ketu ka bashkëpunim pasi që shumica janë shprehur në mënyrë pozitive.

Mësuesi i fëmijës tim është bashkëpunues dhe e ndihmon fëmijën tim të jetë aktiv në mësim



Grafiku nr.3 Sa u ndihmon të jenë aktiv në mësim mësuesi nxënësve kemi mbledh informacion përmes pyetjes me numer 3,ku rezultoi se;54% e prindërve u shprehën se gjithmonë bashkëpunon dhe u ndihmon te jenë aktiv në mësim nxënësve ,22% u shprehen se “shumë herë”,8% shprehen “nuk e di”,9% shprehen “rrallë” dhe 7% në “asnjëherë” janë shprehur.Nga kjo kuptojmë se mësuesi bashkëpunon .

Nëse fëmijë im ka ngecje në mësim,mësuesi u mban mësim shtesë




Grafiku nr.4

Për të evidentuar se sa u mbahet mësim shtesë nxënësve në mënyrë që të rritet suksesi i nxënësve, mendimet e prindërve rezultojnë se; 37,77% e prindërve pohojnë se “asnjëherë” nuk mbahet mësim shtesë. 16,66% e tyre thonë se “rrallë” mbahet . 12.22% e tyre përgjigjen se “nuk

e di “ , 21.11 % e prindërve pohojnë se “shumë here” u mbahet mësim shtesë dhe 12,22% e tyre pohojnë se “gjithmonë” u mbahet mësim shtesë. Shumica rezulton se nuk mbahet mësim shtesë siç pas prindërve .

Mësuesi i fëmiut tim është i vëmendshëm kur fëmiu im nuk përparon dhe përdor metoda të ndryshme për ta nxitur në mësim




Grafiku nr 5

Sa i përket vëmendjes dhe nxitjes në mësim kur nuk përparojnë nxënësit mendimet e prindërve rezultojnë se; 21.11% e prindërve mendojnë se “asnjëherë” nuk është i vëmendshëm dhe nuk i nxit në mësim mësuesi nxënësit, 16.16% e prindërve mendojnë se kjo “rrallë” ndodh, 12.22% e prindërve “nuk e din“, 23.33% e prindërve pohojnë se “ shumë here “i nxit në mësim dhe

është i vëmendshëm dhe 27.77 % pohojnë se kjo ndodh “gjithmonë” nga ana e mësuesit. Këtu kemi një mësues bashkëpunues mbi mesataren .

Fëmiju im është i lirë të pyes mësuesin për atë që nuk e kupton gjatë procesit mësimor




Grafiku nr .6

“gjithmonë” janë të lirë të pyesin për atë që nuk e kuptojnë gjatë procesit mësimor.

Përsa u përket fëmijëve sesa ndjehen të lirë fëmijët të pyesin mësuesin mendimet e prindërve rezultojnë se;14.44% e prindërve mendojnë se “asnjëherë fëmijët nuk janë të lirë të pyesin,10% mendojnë se kjo “rrallë ndodh, ndërsa 8.88% shprehen se “nuk e dinë “kurse 21.11% e prindërve pohojnë se “shumë herë” fëmijët e tyre janë të lirë të pyesin gjatë procesit mësimor, si dhe 45.55% e tyre pohojnë se fëmijët e tyre

Gjatë orës mësimore kur fëmiju im nuk kupton mësuesi ndalon dhe i jep sqarime me shume




Grafiku nr.7

një mësues bashkëpunues te hapur.


Për të evidentuar sesa mësuesi ndalon gjatë orës mësimore për të dhënë sqarime në rast se nuk kuptojnë rezultojnë se; 15.15% e prindërve mendojnë se “asnjëherë” nuk ndalon për të dhënë sqarime më shumë kur nuk kuptojnë, 15.15% mendojnë se “rrallë kjo ndodhë, 8.88% e prindërve nuk e dinë, kurse 26.66 e prindërve mendojnë se shumë herë ndalon për të dhënë sqarime, si dhe 33.33% pohojnë se “gjithmonë” mësuesi ndalon për të dhënë sqarim. Vërejmë

Fëmi im vjen në shtëpi me detyra dhe ka sqarime nga mësuesi si të vazhdojë



Grafiku nr.8


Për të evidentuar se sa janë të udhëzuar në detyra nxënësit nga mësuesi mendimet e prindërve rezultojnë se; 11.11% e prindërve mendojnë se “asnjëherë” nuk janë të udhëzuar dhe nuk kanë detyra, kurse 15.55% pohojnë se “rrallë” kanë dhe janë të udhëzuar në detyra ,6.66% e prindërve “nuk e di” janë përgjigjur, 27.77% e prindërve mendojnë se “shume here” kjo ndodh si dhe 41.11% e prindërve pohojnë se “gjithmonë” janë me detyra dhe kanë sqarime si të vazhdojnë në shtëpi. Detyrat e shtëpisë krijojnë lidhje shkollë-shtëpi ku këtu kemi mësuesin dhe prindërit bashkëpunorë mbi mesataren.



Grafiku nr.9

Sa i përket mbledhjeve mësues-prindër dhe njoftimit i prindërve në kohë nga mësuesi, rezulton se;12.22% e prindërve pohojnë se “asnjëherë” nuk janë të njoftuar dhe nuk mban mbledhje të rregullta, 10% e prindërve shprehen se “rrallë” kjo ndodhë, 2.22% shprehen se “nuk e di” 13.33% pohojnë se shumë herë mbajnë dhe njoftohen për mbledhje dhe 62.22% pohojnë se “gjithmonë” njoftohen dhe mbajnë mbledhje mësues-prindër. Përfshirja e prindërve në kohe krijonë bashkëpunim mes mesuesit dhe nxënësit dhe këtu kemi bashkëpunim ne nivel te duhur.


Mësuesi i fëmijut tim, na dëshmon neve si punohet me fëmijët tanë në shkollë dhe na informon mbi zhvillimin e tyre



Grafiku nr.10

Lidhur me informimin e prindërve mbi zhvillimin e fëmijës dhe punën rreth tyre nga mësuesi rezulton se; 17.77% e prindërve shprehen se “asnjëherë” nuk kanë informata mbi zhvillimin e fëmijëve dhe punën rreth tyre, 16.66% shprehen se “rrallë” kjo ndodhë, 4.44% e tyre “nuk e dinë” kurse 24.44% e tyre pohojnë se kjo ndodhë “shumë herë” dhe 35.55% e tyre pohojnë se “gjithmonë” janë të informuar rreth zhvillimit të fëmijës dhe se mësuesi u dëshmon sesi punohet me fëmijët në shkollë. Nga kjo vërejmë se kemi një mësues të hapur mbi mesataren.


Sa i përket rolit dhe rëndësisë së prindërve për punën edukativo-mësimore të fëmijëve prindërit përmes pyetjes së njëmbëdhjetë mendojnë se; 6.66% e tyre se “asnjëherë” s’ka rëndësi roli i tyre, 12.22% shprehen se “rrallë” mund të kenë rëndësi në punën



Grafiku nr.11

edukativo-mësimore. 4.44% e tyre shprehen se “nuk e di” kurse 16.66% e tyre pohojnë se shumë herë mund të kenë rendësi dhe 58.88% pohojnë se gjithmonë kanë rendësi për punën edukativo-mësimore.


Unë shpreh interesim për takimet apo mbledhjet në shkollë prindër-mësues



Grafiku nr.12

“gjithmonë” kanë interesim për takime apo mbledhje mësues prindër. Interesimi i prindërve rrit bashkëpunimin shkollë –familje ku nga kjo pyetje kemi bashkëpunim nga prinderit mbi mesataren.


